



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC



RAPORT

NGA HULMTIMI I SHPEJTË I VLERËSIMIT TË GJENDJES SË TË DREJTAVE TË FIMIJËS SI DHE TË GJENDJES SË SIGURISË NË SHKOLLAT E KOSOVËS

PROJEKTI: *Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla*

Një përpjekje për të krijuar mundësi dhe shanse të reja për fëmijët e Kosovës!

“Shkelja e të drejtave të fëmijës është një krim i zbutur dhe atak i palejueshëm për të ardhmen e species njerëzore”



Të dashur mësimdhënës mos na trajtoni kështu, sepse ne nuk jemi të tillë!!?

Prishtinë, shkurt 2009

**Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane /
miqësore në shoqëri dhe shkolla**

*Një përpjekje për të krijuar mundësi dhe shanse të reja për
fëmijët e Kosovës!*

**E ardhmja e Kosovës nuk është asgjë tjetër, pos një garë
ndërmjet respektimit dhe mbrojtjes së drejtave të fëmijës dhe
të katastrofës**

Autori i Raportit

Kontakti:

Halim Hyseni

Qendra për Arsim e Kosovës(KEC)

Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”

Rr “Isa Kastrati”,p.n

Prishtinë

Tel/ Fax. 038/244 258, lok.109

E-mail: hhyseni@kec-ks.org

www.kec-ks.org ; www.childrights-ks.org

Ky punim është realizuar në kuadër të projektit” Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla” i përkrahur dhe i financiar nga UNICEF-i me seli në Prishtinë

Të gjitha qëndrimet e shprehura në Raport janë të autorit dhe ne asnjë mënyrë nuk duhet t’i atribuohen UNICEF- it dhe KEC-it

Falënderim:

Autori i këtij raporti shpreh falënderim të veçantë për:

1. Nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët e përfshirë në hulumtim
2. Petrit Tahiri, Koordinator i projektit “Mentorimi i Qendrave të Komunitetit në KEC, për ndihmën e ofruar në zhvillimin hulumtimit dhe futjen e të dhënave në Programin kompjuterik SPSS,
3. Gabrielle Arietano, Programe Officer, në KEC, për ndihmën e ofruar në zhvillimin hulumtimit për sugjerimet dhe idetë e dhëna në interpretimin statistikor
4. Ardita Kabashi Hima, Koordinaore e projektit “Kosovizion Contest” , për zhvillimin intervistave me drejtorë shkollash
5. Falenderimi më i madh i bëhet UNICEF-it i cili pa ndërprerë, me shumë përkushtim dhe në shumë plane është bërë një shtyllë e përhershme në historinë e zhvillimit të gjithanshëm të Kosovës dhe të kthimit të buzëqeshjeve të të gjithë fëmijëve të Kosovës pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, racore, fetare, gjinore, ekonomike dhe shoqërore.

PËRMBAJTJA

- A. SHKURTESAT / 6
- B. BOKSET / 7
- C. FOTOGRAFITË / 7
- D. GRAFIKËT / 7
- E. SKICAT / 8
- F. TABELAT / 8

I. NË VEND TË PARATHËNIES NJË PROLOG I SHKURTË / 9

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE / 11

- 2.1 Standardizimi i sigurisë së mjediseve –domosdoshmëri / 11
- 2.2 Vetëdijesimi i shoqërisë kosovare për rolin dhe rëndësinë e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane, kusht i domosdoshëm për prosperitetin dhe demokratizimin e arsimit dhe të shoqërisë kosovare / 11
- 2.3 Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së drejtave të fëmijës duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë për të krijuar mjedise të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla / 12
- 2.4 Të veçantat e projektit: Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla / 12
- 2.5 Një përshkrim i shkurtë i hulumtimit të shpejtë i bërë me qëllim të vlerësimit të gjendjes së drejtave të fëmijës dhe të sigurisë në mjediset shkollore / 13
 - 2.5.1. Përmbajtja e projektit të hulumtimit / 14
 - 2.5.2. Qëllimi i hulumtimit / 14
 - 2.5.3. Objektivat e hulumtimit / 14
 - 2.5.4. Kampioni i hulumtimit / 14
 - 2.5.5. Metodatat e hulumtimit / 17
 - 2.5.6. Teknika e hulumtimit / 17

III. RAPORT PËR HULUMTIMIN E SHPEJTË / 16

- 3.1. Fushat e hulumtimit / 18
- 3.2. Struktura e njësive të hulumtimit / 18
- 3.3. Roli dhe funksioni i KSHMDF / 20
 - 3.3.1. Puna dhe funksionimi KSHMDF / 22
 - 3.3.2. Si vlerësohet puna e KSHMDF nga mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave / 24
 - 3.3.3. Çfarë propozojnë mësimdhënësit për avancimin e punës së KSHMDF / 25
 - 3.3.4. Roli, rëndësia dhe përdorimi i Kutisë për Drejtat e Fëmijës / 27
 - 3.3.5. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve- këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës / 28

- 3.5.1. Çfarë propozojnë mësimdhënësit për avancimin punës së Këshilltarëve për të Drejtat e Fëmijës /28
- 3.3 Të drejtat e fëmijës në sytë e nxënësve kosovarë 32
- 3.6.1. Mjediset shkollore në Kosovë ende nuk janë mjedise jo të dhunshme? /32
- 3.6.1.1. Pak fjalë për fenomenin dhunës /34
- 3.6.1.2. Edhe pse dhuna e mësimdhënësve ndaj nxënësve ka rënë, dhuna fizike mbi nxënës është një rritje shqetësuese /35
- 3.6.1.3 Duna psikike- shpirtërore një shqetësim legjitim i nxënësve kosovarë /39
- 3.6.1.4 Krijimi i një rrjeti mbrojtës për mjedise të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në shoqëri dhe shkolla /43
- 3.7 Veprimtaritë edukative të Mësimdhënësve në funksion të edukimit për të drejtat e fëmijës /46
- 3.7.1 Si i planifikojnë mësimdhënësit në AD veprimtaritë që lidhen me të drejtat e fëmijës /46
- 3.7.2 Kryerja e përgjegjësive nga nxënësit
- 3.7.3. Sa na ë Kosovë realizohen veprimtaritë jashtëshkollore që lidhen me të drejtat e fëmijës / 47
- 3.7.4. Pjesëmarrja e prindërve që lidhen jashtëshkollore që lidhen me të drejtat e njeriut /49
- 3.7.5. Si trajtohen të drejta e fëmijës në procesin e mësimin /49
- 3.7.6. A ndikojnë mjedisi dhe komunikimi në shkollë në krijimin e klimës së besimit dhe të sigurisë /50
- 3.7.7 A kanë nevojë shkolla për një gazetë- revistë të veçantë kushtuar të drejtave të fëmijës? /51
- 3.7.8 Cilët janë treguesit që më së shpeshti shfaqen në mënyrë të dukshme në marrëdhëniet nxënës – mësimdhënës që janë rezultat i veprimtarive edukative /51
- 3.8 Si udhëheqësit dhe mësimdhënësit e shkollave e vlerësojnë sigurinë në shkolla dhe në komunitet /53
- 3.8.1 Siguria në shkolla dhe në komunitet /53

IV. TIPAT E MJEDISEVE NË SHOQËRI DHE NË SHKOLLA 55

- 4.1 Si e vlerësojnë sigurinë shkollore udhëheqësit dhe mësimdhënësit në AD 57
- 4.2. Dëshmi dhe fakte nga disa studime metaanalitike të bëra në Kosovë 59

V. HIPOTEZAT 61

V. KONSTATIMET PËRFUNDIMTARE 62

VI. REKOMNANIMET 64

A. SHKURTESAT

AD	Arsimi i detyruar nëntëvjeçar
DUDNJ	Deklarata Universale për të drejtat e njeriut
HE	Hulumtime të ekspertëve
HP	Hulumtime participative
HSH	Hulumtime të shpejta
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISSG	Iniciativa për Sigurinë dhe Sigurimin e Grave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KFOR	Kosovo Force
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KRMDF	Komitete Rajonale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
KRRM	Krijimi i rrjetit mbrojtës
KQMBDF	Komiteti qendror për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
KShMDF	Komitete shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
KNSHDF	Këndi shkollor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
KTDF	Kutia e të Drejtave të fëmijës
KMDF	Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
MASHT	Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NJMNV	Njësia për Mbrojtje dhe Viktimave
OJQ	Organizatat Jo – qeveritare
RQDF	Regjistri qendror për të drejtat e fëmijës
SOST	SOS telefoni
ZNJ	Zyra për Ndihmë Juridike
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PATH	Partneriteti Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

SHTQNJ	Sektori Hetues Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
UNDP	Fondi për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
USHPAK	Unioni i Shoqatave të Prindërve dhe Arsimitarëve të Kosovës

B. BOKSET

BOKSI 1	KSHMDF që u dalluan me punën e tyre
BOKSI 2	Neni 27, pikat 1&3 të KDF /21
BOKSI 3	Neni 28 i KDF /54
BOKSI 4	Neni 29 i KDF /55
BOKSI 5	Neni i 30 i KDF /55

C. FOTOGRAFITË

Foto 1.	Moment nga zhvillimi i hulumtimit të shpejtë	/17
---------	--	-----

D. GRAFIKËT

Gr.1.	Njësitë zgjedhore të hulumtimit	18
Gr.2.	Përqindja e fëmijëve të përfshirë në hulumtim sipas moshës	19
Gr.3.	Struktura gjinore e fëmijëve të përfshirë në hulumtim	19
Gr.4.	Struktura gjinore e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim	19
Gr.5.	Struktura kualifikuese e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim	20
Gr.6.	Funksionimi i Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës	23
Gr.7.	Funksionimi i KSHMDF në vendbanimet urbane dhe rurale	24
Gr.8.	Vlerësimi i punës së KSHMDF	25
Gr.9.	Relevanca e propozimeve të mësimitdhënësve për avancimin E KSHMDF	26
Gr.10.	Opinionet e mësimitdhënësve për dobinë e Kutisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës	28

- Gr.11. Përçindja e këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës që veprojnë në vendbanimet urbane dhe rurale 30
- Gr.12. Vlerësimet e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KMDF 30
- Gr.13. Paraqitja grafike e propozimeve të mësimitdhënësve për avancimin e punës së KMDF 32
- Gr.14. Vlerësimet e nxënësve sipas gjinisë për pastërtinë e objekteve shkollore 33
- Gr.15. Paraqitja grafike e propozimeve të mësimitdhënësve për avancimin e punës së KMDF 36
- Gr.16. Paraqitja grafike e përçindjes së nxënësve ndaj të cilëve është ushtruar/nuk është ushtruar dhuna fizike 36
- Gr.17. Përdorimi i dhunës fizike mbi nxënës sipas gjinisë 38
- Gr.18. Dhuna e ushtruar mbi nxënës sipas gjinisë dhe ushtruesve të dhunës /41
- Gr.19. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen: ” A planifikoni në mësimitdhënien veprimtari që lidhen me edukimin për të drejtat e fëmijës ” /47
- Gr.20. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen: “A realizoni veprimtari jashtëshkollore që lidhen me të drejtat e fëmijës?” /48
- Gr.21. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen: ” A marrin pjesë prindërit në veprimtari që zhvillojnë ju në shkollë për të drejtat e fëmijës ” /49
- Gr.22. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen: “Si i trajtoni të drejtat e fëmijës në procesin mësimor” /50
- Gr. 23. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen: “A duhet shkolla e juaj të ketë një gazetë – revistë të veçantë për të drejtat e fëmijës” /51
- Gr. 24. Treguesit më të shpeshtë dhe më të dukshëm në raportet nxënës – mësimitdhënës që janë rezultat i aktiviteteve edukative për të drejtat e fëmijës” /53
- Gr. 25. Vlerësimet e mësimitdhënësve për disa llojet të sigurisë në shoqëri dhe në shkollë /59
- Gr.26. Paraqitja grafike e disa sjelljeve asociale të fëmijëve të mitur në Kosovë mbi bazën e një hulumtimi /60

E. SKICAT

- Sk.1. Ndërlidhjet kauzale të mjediseve me efikasitetin dhe efektivitetin e edukimit 13
- Sk. 2. Cikli i pasojave të mundshme për nxënës nga fyerjet dhe ofendimet e mësimitdhënësve/. Profilet e fëmijës: viktimë; ushtrues i dhunës / 44
- Sk. 3. Itinerari i adresimit dhe të parandalimit të dhunës /Një model hipotekë i Rrjetit Mbrojtës të Mjedisëve të Sigurta, Jo të Dhunshme dhe Humane në Shoqëri dhe në Shkollë?/ 45

- Sk.4. Kthesa civilizuese e dhunës në Mjediset e Sigurta, Jo të Dhunshme dhe Humane/Miqësore në Shoqëri dhe në Shkolla 46
- Sk. 5. Kompleksitet i krijimit të mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla 57

F. TABELAT

- T-1. Pasqyra tabelare e komunave, shkollave, KSHMDF, KMDF të përfshira në hulumtim të shpejtë 16
- T- 2. Frekuenca e respondentëve- nxënës të përfshirë në hulumtim 18
- T- 3. Shkalla e funksionimit të KSHMDF 22
- T-4. Vlerësimet e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KSHMDF 24
- T-5. Propozimet e mësimitdhënësve për avancimin e punës së KSHMDF 25-26
- T-6. Vlerësimet e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KSHMDF 29
- T-7. Propozimet e mësimitdhënësve për avancimin e punës së KMDF 31
- T-8. Përdorimi i dhunës mbi nxënës nga aspekti gjinor 35
- T- 9. Ushtruesit e dhunës mbi nxënës nga aspekti gjinor 37
- T- 10. Pasqyra e ushtruesve të dhunës psikike mbi nxënës
- T-11. Fjalët dhe shprehjet me të cilat mësimitdhënësit atakojnë dinjitetin nxënësve 42-43
- T.12. Mënyrat se si i trajtojnë mësimitdhënësit të drejtat e fëmijës 49
- T-13. Treguesi që më së shpeshti shprehen në raport nxënës- mësimitdhënës dhe që janë rezultat i aktiviteteve edukative 52
- T-14. Si i vlerësojnë mësimitdhënësit dhe drejtorët llojet e caktuara të sigurisë në shkolla 58

I. NË VEND TË PARATHËNIES NJË PROLOG

Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla është **një kusht elementar për maksimalizimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit të arsimit në Kosovë**, në përgjithësi, dhe të atij të detyruar në veçanti. Po ashtu, krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane / miqësorë për fëmijë me nxënësin në qendër është *condititio sine qua non* për **ndërtimin e një shoqërie demokratike, multikulturale, multietnike me njeriun në qendër**(Lexo: nenin 31 të KDF). Vetëm shoqëritë me njeriun në qendër janë shoqëri kohezive dhe të lumtura.

Vendosja e njeriut në qendër **nuk mund të realizohet pa edukimin e qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në kuadër të saj edhe të drejtave të gruas dhe të fëmijës.**

Çështja, siç edhe mund të përfundohet, është shumë komplekse, sepse, ne vete ngërthen llojllojshmëri dëshirash, pluralitet interesash dhe të mendësive, si dhe të vizioneve të ndryshme ndaj të ardhmes etj.

MASHT , UNICEF, DHE KEC të prirë nga dëshira që të kontribuojnë **në krijimin e një sistemi të arsimit i cili do jetë i mirë dhe i dobishëm për të gjithë** dhe që në të njëjtën kohë i cili është **interes individual dhe nacional i secilit** qytetarë të Kosovës pas shume **debatesh dhe diskutimesh u pajtuan që të hartojnë një projekt** i cili do të ketë **impakt pozitiv të drejtpërdrejtë në tërësinë** sistemit të arsimit të obliguar duke llogaritur që ndikimi indirekt do të jetë edhe në nivelet tjera të arsimit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Pajtimi që të hartojmë një projekt, që do ketë impakt të drejtpërdrejtë në tërësinë e sistemit të arsimit të obliguar-AD, na vuri para dilemave të tjera të mëdha, që kishin të bënin me **identifikimin e fushave në të cilat mbulohen dëshirat dhe plotësohen interesat e ndryshme të qytetarëve të Kosovës**. Pas një shoshitjeje të gjatë erdhëm në përfundim se **çështja më pranueshme mbi të cilën duhet ndërtuar parimet e integritit të interesave plurale dhe të mendësive të ndryshme janë të drejtat e njeriut, gruas dhe të fëmijës**. Megjithatë, fusha e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të drejtat e gruas dhe të fëmijës janë fusha të gjera për një projekt që do të zbatohet për një vit dhe i cili do të duhet të ketë efekte të prekshme dhe të vëzhgueshme **u vlerësuan si të pa papërballueshme**.

Gjatë një **braistormingu të këtillë u evidentua një çështje që ishte interes dhe brengë e të gjithë qytetarëve pavarësisht prej përkatësisë etnike**. Fjala ishte për **sigurinë, e cila** , sipas këtij studimi ishte pjesë e mendësisë dhe e shqetësimit të shumicës qytetarëve të Kosovës (rezultate kishin të bënin me vitin 2005).

Ne identifikimin e projektit ne nuk u bazuam në konstatimet e këtij studimi, por, u nisëm nga premisa se **mjediset e sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla janë interes i të gjithë qytetareve të Kosovës**. Në anën tjetër, njohjet tona teorike dhe përvojat nga hulumtimet e bëra na imponon bindjen se duhet të angazhohemi që të krijojmë hapësira të sigurta, jo të dhunshme dhe humane /miqësore për fëmijë, sepse vetëm në hapësirat humane dhe miqësore për fëmijët mund të zhvillohen fëmijët tanë deri te kufijtë e tyre te skajshëm gjenetik, fiziologjik, fizik, mental emocional dhe social.

Është qartë se krijimi i mjediseve të sigurta jo të dhunshme/ miqësore për fëmijë nuk është i lehtë, por për këtë kishim një përvojë pozitive sepse UNICEF në bashkëpunim me MASHT kishte krijuar kapacitetet dhe një bazë solide konceptuale për **shkollat miqësore** në Kosovë/. Në anën tjetër: MASHT, KEC, TRACAIRE, UNICEF, ILO IPC **kishin krijuar disa struktura të specializuara për promovimin e të drejtave të fëmijës**. Në periudhën 2003-2006 në arsimin fillor dhe të mesëm këto organizata kishin aftësuar mbi **1 400** mësimdhënës- këshilltarë për të drejtat e fëmijës¹. Gjatë kësaj periudhe ishin themeluar mbi **400** komitete shkollore (në to ishin përfshirë **mbi 9 000 fëmijë**). Në shumë shkolla ishin vendosur **Kutitë për të Drejtat e Fëmijës**.

Gjatë kësaj periudhe në Kosovë janë organizuar disa hulumtime të cilat tregojnë për dhunën e pa toleruar në mjediset e ndryshme shkollore dhe familjare. Hulumtime të këtilla kishin zhvilluar KEC, 2003, 2005, 2008; UNICEF, 2005, MASHT 2006, Save the Children 2002 dhe 2003. Është e evidente se mjediset shkollore dhe familjare në masë të pa tolerueshme karakterizohen me dhunë.

Këto argumente bënë që MASHT, UNICEF dhe KEC të pajtohen për miratimin e projektit: **Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane. Projekti ka filluar të zbatohet në shtator të vitit 2008.**

Pjese e këtij projekti ka qenë edhe organizimi i një hulumtimi të shpejtë me qëllim të vlerësimit të shkallës së sigurisë së mjediseve shkollore, gjendjen e të drejtave të fëmijës dhe shkallën e përdorimit të dhunës në mjediset shkollore.

Meqë çështja është shumë komplekse për vitin e parë janë përcaktuar dy synime kryesore të këtij projekti:

- A. Ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane/miqësore për fëmijë në shoqëri dhe në shkolla; dhe,
- B. Krijimi i një rrjeti mbrojtës i cili do të parandalonte dhunën në shoqëri dhe shkolla dhe do të krijonte të sigurta, me më pak të dhunë dhe që do jenë më miqësore për fëmijë .

Por, kjo gjë nuk do të mund të bëhej mbi parimin e Kutisë së Zezë, pa njohjen e për afërt të gjendjes reale. Për këtë qëllim është zhvilluar hulumtimi, rezultatet të cilit prezantohen në këtë raport.

Ajo çka kemi konstatuar se rezultat pozitiv të cilat paraqiten si të arritura janë :

- + ngritja vetëdijes për dëmet që sjell dhuna fizike dhe psikike dhe së rezultat të kësaj kemi konstatuar zvogëlimin e dhunës psikike dhe fizike mbi nxënës **nga mësimdhënësit** që është lajm i mirë , por krahas saj kemi një lajm të keq që lidhte në mënyrë rapide me **keqtrajtimin i fëmijëve nga fëmijët moshatarë apo Bulliung-u.**
- + Rezultatet empirike janë trajtuar në dritën e një studimi teorik të karakterit meta-analitik, me që rast janë trajtuar rezultatet dhe gjetjet e deritashme të hulumtimeve të bërë në Kosovë në fushën e mbrojtjes së drejtave të fëmijës dhe të gruas.

Mbi bazat e këtij hulumtimi është propozuar edhe **një rrejt mbrojtës i cili** së bashku me Raportin do të shqyrtohen në një nga punëtoritë një ose dy ditore, që do të zhvillohen në fund të muajit shkurt apo fillimit të muajit mars 2009. Në punëtorinë, 1 apo 2 ditore do të trajtohen gjetjet nga hulumtimi, struktura dhe drejtimit programore të modeleve hipotetike **të mekanizmit mbrojtës**

¹ Shih: www.childrights-ks.org

II. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

2.1. Standardizimi i sigurisë së mjediseve domosdoshmëri!

Qendra për Arsim e Kosovës, në bashkëpunim me UNICEF-in, është duke bërë përpjekje që të kontribuojë në krijimin mjediseve stimulative, të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe në shkollat e Kosovës, sepse vetëm në mjediset e këtilla është i mundur zhvillim maksimal i fëmijëve në pajtim me nenet: 28, 29 dhe 30 dhe 31 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës(KDF). Krijimi i mjediseve të këtilla është një çështje komplekse sepse, ato duhet të përkufizohen dhe mirë të standardizohen, në mënyrë që mund të identifikohen, duke i bërë të matshme. Kjo nënkupton, që në shkolla duhet hartuar paketë të standardeve për mjediset të sigurta, jo të dhunshme dhe humane. Mungesa e standardeve, ka ndikim negativ në krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shkolla, sepse, vështirësojnë tej mase monitorimin dhe vlerësimin e tyre, si dhe kanë ndikim negativ në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit.

2.2. Vetëdijesimi i shoqërisë kosovare për rolin dhe rëndësinë e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane, kusht i domosdoshëm për prosperitetin dhe demokratizimin e arsimit dhe të shoqërisë kosovare

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane kërkon një vetëdijesim, si të shoqërisë, ashtu edhe familjeve dhe të institucioneve arsimore. Për këtë qëllim duhet hartuar projekte të mëdha vetëdijesimi si dhe paketa ligjore me të cilat do të funksionojë shteti ligjor, sundimit i ligjit dhe me të cilat të gjithë qytetarët e Kosovës do jenë të barabartë para ligjit. Korniza e tashme ligjore nuk krijon bazë të qëndrueshme për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla. Problem tjetër që lidhet me kornizën ligjore ka të bëjë me të vetëdijen zbatimin e ligjeve. Në reformat kurrikulare duhet të adresohet edukimi i fëmijëve për respektimin e ligjeve

Për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane përgjegjësia është e shpërndarë në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Për realizimin e kësaj kërkesë nevojitet ndihma e bashkësisë ndërkombëtare, fuqizimi i pedagogjisë së paqes, duhen bërë reforma kurrikulare, ku roli dhe rëndësia e krijimit të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane me fëmijën në qendër do të adresohen drejtë dhe mirë si në aspektin e përmbajtjes, ashtu ehe të metodologjive të realizimit.

Mjete e informacionit kanë rol dhe rëndësi të veçantë. Gazetarët duhet të ndërrojnë narrativin e tyre të përcjellës të informacionit. Ata duhet të jenë hulumtues njohës dhe pasionant të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti.

Ekzekutivi, gjyqësia dhe prokuroria kanë rol më rëndësi. Ata duhet të përfshihen në trajnime të veçanta, sidomos në fushën e drejtësisë restorative².

² Shih më gjersisht: Murati.V&Klllokoqi, S.(2008) Masat alteranative në sistemin drejtësisë për të mitur në Kosovë. Puna në dobi të përgjithshme si dënim dhe si masë e diversitetit. Universiteti i Prishtinës. Qendra për të Drejtat e Njeriut

2.3. Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së drejtave të njeriut dhe të fëmijë duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë për krijuar të mjedise të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

Në të gjitha nivelet e shkollimit duhet të fuqizohet edukimi për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës. Kjo lëndë duhet të jetë lëndë e detyrueshme në të gjitha nivelet e edukimit dhe të arsimit dhe duhet të mësohet si **pedagogji e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës**. Në **reformën kurrikulare** duhet shikuar mundësinë që lënda “*edukata qytetare*” të zëvendësohet me lëndën “*të drejtat e njeriut- fëmijës*” dhe të mësohet nga edukimi parashkollor deri te në arsimin e lartë universitare(kjo lëndë duhet të futet në të gjitha fakultetet).Lënda **edukata shoqërore apo edukata qytetare** është **me e përgjithësuar dhe me abstrakte** dhe me pak e fokusuar në njeriun , përkatësisht në fëmijën. Kjo do të thotë se në **edukatën shoqërore**, përkatësisht në **edukatën qytetare , njeriu - fëmija, nuk është qendër**, ndërsa me lëndën **të drejtat e njeriut dhe të fëmijës**, përkatësisht të fëmijës dhe të njeriut, varësisht nga niveli i edukimit njeriu , përkatësisht fëmija, vendoset në qendër.


Me qëllim të njohjes së gjendje së drejtave të fëmijës dhe të krijimit të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore për fëmijë duhet të krijohet sistem – rrjet i fuqishëm i monitorimit të gjendje së drejtave të fëmijës, sepse nuk mund të hartohen strategji dalëse dhe avancuese me metodën e “**KUTISË ZEZE**” . Për këtë qëllim duhet një bashkëpunim shumë më i sinkronizuar i institucioneve të Kosovës, i shoqërisë civile dhe i ekspertëve të cilit merren me të drejtat e fëmijës.

Me qëllim të zbardhjes së gjendjes së drejtave të fëmijës duhet të zhvillohen **hulumtime të shpejta(HSh)** sepse këto pasqyrojnë me së miri gjendjen reale. Hulumtimet e këtilla munden jenë **hulumtime të ekspertëve- HE** ose **hulumtime participative-HP**

2.4. Të veçantat e projektit: Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës dhe UNICEF, në bashkëpunim intensiv në shumë fusha kanë arritur në përfundim se mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane ž miqësore për fëmijë jon kusht themelor dhe ekzistencial për zhvillimin plotë të personaliteti të fëmijës ashtu siç edhe kërkojnë standardet ndërkombëtare dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjatë planifikimit dhe definimit të projektit ka qenë mendim i përbashkët se mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore, **janë shkak dhe pasojë e sistemit të edukimit**. Janë shkak se këto mjedise në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit në të gjitha përmasat e tij, dhe janë pasojë sepse edhe efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit të arsimit kanë ndikim të fuqishëm dhe të drejtpërdrejtë në krijimin mjediseve të sigurta jo të dhunshme dhe humane / miqësore për fëmijë. Kjo ndërlihdje e mjediseve të sigurta jo të dhunshme dhe humane / miqësore për fëmijë shihet qartë në Sk. 1.

Sk.1. Ndërlidhjet kauzale të mjediseve me efikasitetin dhe efektivitetin e edukimit



Duke e identifikuar këtë kauzalitet, i kemi definuar dy synime të përgjithshme të projektit:

- ✚ **Ngritjen e vetëdijes për krijimin** e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane / miqësore për fëmijë(organizimi i Panairit për të drejtat e njeriut – fëmijës; tryezat, mediat, ekspozitat dhe punimet e nxënësve: HULUMTIMET PARTICIPATIVE-HP ; si dhe
- ✚ **Krijimin e një rrjeti mbrojtës - KRRM** të fuqishëm i cili do të punojë në sigurimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme në shoqëri dhe shkolla

2.5. Një përshkrim i shkurtër për hulumtimin shpejtë i bërë me qëllim të vlerësimit të gjendjes së drejtave të fëmijës dhe të sigurisë në mjediset shkollore

Krijimi i mjediseve të sigurta jo të dhunshme dhe humane// ,miqësore nëpërmjet të një KRRM nuk ishte i mundur pa e bërë një zbardhje të gjendjes së drejtave të fëmijës dhe gjendjes së sigurisë në institucione shkollore të arsimit të detyruar (AD).

Në hulumtim të shpejtë janë përfshirë:

- ✚ 183 shkolla fillore dhe të ulëta të mesme në Kosovë
- ✚ 191 drejtorë shkollash
- ✚ 93 mësues dhe;
- ✚ 204 nxënës të klasave të shtata të arsimit të ulët të mesëm

Për realizimin hulumtimit të shpejtë (HSH) janë zhvilluar këto aktivitete

- është hartuar projekti i hulumtimit me instrumentet përkatëse;
- është formuar ekipi hulumtues në përbërje: Halim Hyseni , udhëheqësi i ekipit hulumtues, Gabrielle Arietano, Ardita Kabashi Hima dhe Petrit Tahiri;

- c. janë identifikuar 183 shkolla, në të cilat është realizuar hulumtimi
- d. hulumtimi është zhvilluar gjatë muajit tetor 2008
- e. futja e të dhënave në programin SPSS është bërë gjatë muajit nëntor
- f. analiza statistikore është bërë gjatë muajit nëntor dhjetor 2008
- g. interpretimi dhe analiza e të dhënave me studimin komparative të gjetjeve të hulumtimeve më të hershem të bëra në Kosovë, në periudhën janar 2000 dhjetor 2008 dhe janar dhe shkurt 2009

2.5.1. Përmbajtja e projektit të HSH

Projekti i hulumtimit është hartuar gjatë muajit shtator. Projekti përmban:

- a. Qëllimin i hulumtimit
- b. Objektivat e hulumtimit
- c. Kampionin
- d. Metodën e hulumtimit
- e. Teknikat e hulumtimit
- f. Instrumentet e hulumtimit
- g. Hipotezat e hulumtimit
- h. Dinamikën e organizimit të hulumtimit

2.5.2. Qëllimi i hulumtimit

Hulumtimit ka për qëllim të vlerësojë:

- ✚ *punën e Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës*
- ✚ *punën e mësimitdhënësve – këshilltarëve për të drejtat e fëmijës*
- ✚ *gjendjen e të drejtave të fëmijës në arsimin e obliguar*
- ✚ *gjendjen e sigurisë në shkollat e Kosovës*

2.5.3. Objektivat e hulumtimit

- ✚ *t'i identifikojë numrin shkallën e funksionimit të Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës(KSHMDF) dhe faktorët që kanë ndikuar dhe mund të ndikojnë në avancimin punës KSHMDF*
- ✚ *t'i identifikojë dhe vlerësojë ndikimin punës mësimitdhënësve - këshilltarëve për të drejtat e fëmijës(KSHDF) në avancimin dhe mbrojtje e të drejtave të fëmijës*
- ✚ *t'i identifikojë faktorët që mund të ndikojnë në avancimin punës së këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës*
- ✚ *t'i identifikojë aktivitetet e mësimitdhënësve që lidhen me edukimin për të drejtat e fëmijës*
- ✚ *të konstatojë gjendjen e të drejtave të fëmijës në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët*
- ✚ *të konstatojë shkallën e sigurisë së mjediseve shkollore*

2.5.4. Kampioni i hulumtimit

Me qëllim të hulumtimit – vlerësimit të shpejtë të funksionimit të komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në 21 komuna janë përfshirë gjithsej 183 shkolla në të cilat mësimi zhvillohet në pesë gjuhë mësimore: shqipe, serbe, boshnjake, turke, dhe kroate. Numri i shkollave të përfshira paraqitet në T-1.

Hulumtimi është bërë edhe në shkollat me mësim në gjuhë serbe. Shkolla me mësim në gjuhën serbe që janë përfshirë në hulumtim janë: 1. “ Vuk Karaxhiq” në Fushë Kosovë; 2. Shkolla në Uglar në Fushë Kosovë; 3. Shkolla “Aca Maroviq “ në Fushë Kosovë; 4. ”Dositej Obradoviq” në Palaj - Obiliq; 5. “Milan Rakiq” në Bajmovc; 6. “Sveti Sava” në Plemetin; 7. Branko Radiqeviq” në Obiliq 8. “Svetozar Markoviq” Hoqë e Madhe; 9.”Vuk Karaxhiq” Rahovec ; 10. “Sveti sava “ në Kllokot; 11. “Marko Rajkoviq” Mogillë ; 12. “Mladen Markoviq’ në Viti. Në këto shkolla është përdore intervista me anë të telefonit

Shkollat tjera janë shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, gjuhën turke dhe boshnjake. Pesë nga këto shkolla mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke.

Numrin shkollave dhe i të drejtorëve të përfshirë në hulumtim sipas komunave paraqitet në T- 1.

T-1. PASQYRA TABELARE E KOMUNAVE , SHKOLLAVE, KOMITETEVE DHE TË KËSHILLTARËVE PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

Nr.	Emërtimi i komunës	Numri i shkollave	Nr. i KSH që funksionojnë			Nr. KSH që nuk funksionojnë			Numri i këshilltarëve për të drejtat e fëmijës		
			Qytet	Fshat	Gjiths.	Qytet	Fshat	Gjiths.	Qytet	Fshat	Gjih.
1.	Artanë-Novobërdë	5	1	0	1	0	4	4	2		2
2.	Deçan	18	1	13	14	0	4	4	13	19	32
3.	Dragash- Sharr	2	-	2	2	-	-		-	12	12
4.	Ferizaj	20	4	4	8	1	11	12	7	4	11
5.	Fushë Kosovë	5	0	-	0	5	-	5	0	-	0
6.	Gjakovë	5	3	-	3	2	-	2	29	-	29
7.	Gjilan	12	6	5	11	0	1	1	27	10	37
8.	Istog – Burim	2	2	-	2	0	-	0	6	0	6
9.	Kaçanik	2	2	-	2	0	-	0	5	-	5
10.	Kamenicë- Dardanë	5	0	4	4	1	-	1	0	9	9
11.	Klinë	2	1	1	2	0	-	0	2	5	7
12.	Lypjan	1	0	-	0	1	-	1	3	-	3
13.	Mitrovicë	20	6	6	12	3	5	8	14	19	33
14.	Obiliq – Kastriot	7	0	1	1	3	3	6	0	2	2
15.	Pejë	13	5	7	12	0	1	1	28	19	47
16.	Podujevë	17	2	9	11	1	5	6	16	27	43
17.	Prishtinë	12	10	-	10	2	-	2	34	-	34
18.	Prizren	14	4	5	9	4	1	5	32	27	59
19.	Rahovec	2	0	0	0	1	1	2	0	0	0
20.	Therandë-Suharekë	4	4	-	4	0	-	0	17	-	17
21.	Viti	15	1	4	5	0	10	10	5	10	15
	Gjithsej	183	52	61	113	24	46	70	240	163	403

2.5.5. Metodatat e hulumtimit

Në hulumtim janë përdorë këto metoda:

- a. Metoda historike
- b. Metoda kauzave
- c. Metoda e interpretimit statistikor

2.5.6. Teknikat e hulumtimit të shpejtë

Në hulumtim janë përdorë këto teknika të hulumtimit të shpejtë:

- a. Teknika e analizës dhe studimit të dokumentacioni pedagogjik
- b. Teknika e anketimit
- c. Teknika e intervistimit
- d. Teknika e topit dëborës



Foto 1. Moment nga zhvillimi i hulumtimit të shpejtë

III. RAPORT PËR HULUMTIMIN E SHPEJTË

3.1. Fushat e hulumtimit


Në këtë raport përfshihen këto aspekte të hulumtimit:

- ✚ Struktura e njësive zgjedhore – respondentëve
- ✚ Puna dhe funksionimi i komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- ✚ Puna dhe roli i këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- ✚ Roli i Kutisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- ✚ Opinionet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe të drejtorëve të shkollave për gjendjen e të drejtave të fëmijës
- ✚ Veprimtaritë edukative të mësimitdhënësve në funksion të edukimit për të drejtat e fëmijës
- ✚ Vlerësimi i gjendjes së sigurisë në shkolla e Kosovës
- ✚ Përfundimet e hulumtimit
- ✚ Rekomandimet për avancimin e sigurisë në mjediset shoqërore në dhe në shkolla, në krijimin e mjediseve jo të dhunshme dhe humane / miqësore në shoqëri dhe në shkolla
- ✚ Shtojcat

3.2. Struktura e njësive zgjedhore të përfshira në hulumtim

Në grafikun 1 paraqiten të gjitha njësitë zgjedhore të përfshira në hulumtimin e shpejtë

Gr.1. Njësitë zgjedhore të përfshirë në hulumtim të shpejtë




T-2. Frekuenca e respondentëve - nxënës të përfshirë sipas moshës

Mosha	Frekuenca (f)	Përqindja	Frekuenca kumulative fc
12	8	3.9	3.9
13	81	39.7	43.6
14	73	35.8	79.4
15	42	20.6	100
Totali	204	100	


Siç mund të konstatohet se numri më i madh i fëmijëve ka qenë i moshës 13 vjeçare. Kjo më qartë shihet nga grafikun nr.2

Gr.2. Përqindja e fëmijëve të përfshirë në hulumtim sipas moshës




Strukturën gjinore e fëmijëve të përfshirë në hulumtim e paraqesim në grafik 3.

Gr.3. Struktura gjinore e fëmijëve të përfshirë në hulumtim




Në hulumtim pjesa më e madh e mësimeve janë të gjinisë femërore. Kjo shihet qartë në grafikun 4. Kjo strukturë është e përafërt me strukturën gjinore në vendbanimet urbane

Gr.4. Struktura gjinore e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim



Në Gr. 5. paraqesim strukturën kualifikuese të mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim



Në grafik shihet qartë se **përqindja më e madhe e mësimdhënësve në AD është me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare.** Është një kualifikim i ulët që **dallon nga standardet e vendeve të zhvilluara dh që ka ndikim edhe në gjendjen e të drejtave të fëmijës.**

3.3. Roli dhe funksioni KSHMDF

Komitetet shkollorë³; janë struktura të formuara të nxënësve në shkollat e arsimit fillor dhe të ulët të mesëm. Këto struktura janë formuar në përputhje me **Udhëzimin për Formimin Komiteteve Shkollorë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës⁴**

³ **Komitet shkollorë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (KSHMDF)** janë formuar në periudhën 2003-2006, mbi bazën e projektit: *”Edukimi për të drejtat e fëmijës”* të financuar nga TROCAIRE dhe të **Memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar** nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Qendra për Arsim të Kosovës. KSHMDF, janë një struktura origjinale që mund të jenë një adresë e shkëlqyer për adresimin e të gjitha shkeljeve të drejtave të fëmijës në institucionet arsimore të AD. Gjatë periudhës 2003-2006 KSHMDF, kanë luajtur një rol shumë pozitiv në avancimin e të drejtave të fëmijës në Kosovë. Tregues për këtë janë qindra emisione në radio, dhjetëra shkrime në gazeta të ndryshme, qindra takime të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe të shoqërisë civile, duke i përfshirë këtu edhe OJQ-ët e ndryshme (shih : Aneksin 4). M përfundimin e projektit, puna e KSHDMF nuk është monitoruar. Meqë,

Qëllimi i KSHMDF është fuqizimi i rolit të fëmijëve- nxënësve në mbrojtjen dhe avancimin të drejtave të fëmijës dhe në krijimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme , humane / miqësore për fëmijët. KSHMDF janë vende ku duhet adresuar dhunën dhe parandaluar shkeljet tjera të drejtave të fëmijës. Komitetet shkollore përbëhen nga përfaqësuesi e klasave dhe të paraleleve të shkollës fillore dhe të ulët të mesme. Kjo strukturë varësisht nga numri i paraleleve dhe i nxënësve të shkollave mund të përbëhen nga 7 deri 19 e më shumë anëtarë.

Nën mbikëqyrjen e KSHMDF vendoset **Kutia për të drejtat e fëmijës-KTDF** si dhe **Këndi shkollor i të drejtave të fëmijës- KNSHDF**; përcaktohet dhe mbahet **Regjistri qendror për evidentimin e shkeljes së të drejtave të fëmijës dhe për shkallën e sigurisë në shkollë**; Detyra e KSHMDF janë:

- ✚ Të organizojnë hulumtime të vogla me qëllim të identifikimit të nevojave dhe interesimeve të fëmijëve (1)
- ✚ Të organizojnë hulumtime dhe vlerësime të shpejta për matjen e temperaturës- gjendjes së drejtave të fëmijëve (2)
- ✚ Të hartojnë plane vjetore dhe mujore të punës së Kryesisë së Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (3)
- ✚ Të organizojnë debate dhe diskutime për gjendjen e të drejtave të fëmijës në shkolla (4)
- ✚ Për çdo muaj në bashkëpunim me këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të organizojnë nga një vlerësim për gjendjen e sigurisë në shkolla, për parandalimin dhunës dhe për krijimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme (5)
- ✚ Të organizojnë ligjërata të ndryshme duke ftuar ekspertë për të drejtat e fëmijës (6)
- ✚ Të organizojnë fushata vetëdijesimi (shënimi i ditëve të caktuara që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës) (7)
- ✚ Organizojnë ekspozita, gara diturisë për të drejtat e fëmijës (8)
- ✚ Mirë-mbanë **Këndin shkollor për të Drejtat e fëmijës (9)**
- ✚ **Muaj për muaj hap Kutinë e të drejtave të fëmijës dhe të shkruaj raport për ankesat, vërejtjet dhe sugjerimet e fëmijëve që lidhen me të drejta e tyre (10)**
- ✚ **Mbanë Regjistrin Qendror për shkeljen e të drejtave të fëmijës në shkollë dhe për rastet e dhunës mbi fëmijë (11)**
- ✚ **Mban lidhjet telefonike me organizata që merren me të drejtat e fëmijës dhe personin MASHT- përgjegjës për të drejtat e fëmijës (12)**
- ✚ Dy herë gjatë vitit shkollor raporton për gjendjen e të drejtave të fëmijës dhe shkallën e sigurisë në shkollë (13)
- ✚ Bashkëpunon me këshilltarët për të drejtat e fëmijës Udhëheqjen e shkollës, Këshillin e Shkollës dhe më Këshillin e prindërve(14),
- ✚ Bashkëpunon me Komitetet Rajonale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (KRMBDF) (15)

Realizimi i këtyre 15 veprimtarive të KSHMBDF drejtpërdrejt mund të kontribuon në:

KSHMDF, mund të kenë ndikim të fuqishëm në rritjen e sigurisë në institucionet arsimore, me projektin: Krijimi i mjediseve të sigurta ,jo të dhunshme dhe humane/miqësore për fëmijë, është paraparë që të bëhet fuqizimi i këtyre strukturave duke i integruar në një rrjet i cili do të jetë, jo vetëm një mbrojtës i të drejtave të fëmijës , por edhe adresë e cila do të kontribuojë që të promovohen të drejtat e fëmijës duke krijuar mjedise miqësore dhe jo të dhunshme në institucionet arsimore.

⁴ Shih: www.childrights-ks.org

- ✚ Krijimin i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shkolla dhe në shoqëri
- ✚ Përfshirjen dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje për të gjitha çështjet që janë me interes për nxënësit
- ✚ Promovimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Zgjerimin e bazës së subjekteve që do të përfshihen në krijimin mjediseve të sigurta ,jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla
- ✚ Avancimin e cilësisë së punës të institucioneve arsimore duke shtuar përgjegjësitë të të gjitha subjektet edukative

BOKS.1. KSHMDF QË U DALLUAN ME PUNËN E TYRE

Gjatë monitorimit të punës së KSHMDF kemi konstatuar se disa komitete shkollore veçohen me punën e tyre. Ndër këto komitete që veçohen me punën e tyre janë:

1. Komiteti Shkollor për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Shkollën fillore: **“Abdyl Frashëri”** në Prizren
2. Komiteti shkollor për Mbrojtjen të Drejtave të Fëmijës në shkollën fillore **“Hilmi Rakovica “** në Prishtinë
3. Komiteti shkollor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shkollën fillore **”Ull Morina”** në Gjakovë

Gjatë hulumtimit kemi konstatuar se mbështetja e udhëheqjes së shkollës për punën e komiteteve shkollore është me rëndësi të madhe. Pas ardhjes së udhëheqjes së re, **në shkollën “Meta Bajraktari”** në Prishtinë, KSHMDF në këtë shkolla që nga fillimi i këtij viti ka zhvilluar shumë aktivitete

3.3.1. Puna dhe funksionimi i KSHMDF

Në hulumtimin shpejtë kemi pasur për qëllim të konstatojmë gjendjen faktike të funksionimit të **KSHMDF**. Për të konstatuar shkallën e funksionimit kemi anketuar: **183 drejtorë shkollash dhe 204 nxënës**

Nga T- 1 mund të konstatohet se nga 183 shkolla sa kanë qenë objekt hulumtimi me qëllim të vlerësimit të shkallës së funksionimit të komiteteve shkollore, **në 113 apo 61.75% të shkollave funksionojnë komitetet shkollore dhe në 70 shkolla apo 38.25% nuk funksionojnë KSHMDF.**

Nga T-1 po ashtu, shihet qartë se shkalla më e madhe **mosfunksionimit të komiteteve shkollore është shkollat rurale** në të cilat prej gjithsej 107 shkollave të përfshira në hulumtim, vetëm në **61 shkollë apo 57.01% funksionojnë dhe në 46 shkolla apo 42.99% nuk funksionojnë komitete shkollore.**

Përqindja e funksionit të komiteteve shkollore në shkollat urbane është shumë me lartë sepse prej 76 shkollave të përfshira në hulumtim në 52 apo 68.42% të shkollave funksionojnë dhe në 24 apo 31.58%, nuk funksionojnë KSHMDF

Ky vlerësim i shpejtë tregon se për krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shkolla duhet të themelohen komitetet shkollore në të gjitha institucionet arsimore të AD.

Nëpërmjet intervistave(“*kokë më kokë*”, *intervistave me anën e telefonit*, me metodën e “*topave të borës*) dhe anketimeve të zhvilluar me nxënës, mësime dhe drejtorë e

zëvendësdrejtorë shkollash kemi një gjendje jo të mirë të funksionimit të KSHMDF. Kjo gjendje e funksionimit të komiteteve shkollore paraqitet në T-2

T-3. Shkalla e funksionimit të KShMDF


Nr.	Subjektet e përfshira në hulumtim	Gjith.	Funksionojnë		Nuk funksionojnë		Pa përgjigje	
			Numri	%	Numri	%	Nuri	%
1.	Nxënësit(anketuar)	204	112	54.9	88	43.1	4	2
2.	Drejtorët(intervistuar)	183	113	61.75	70	38.25	0	0
3.	Drejtorë të anketuar	8	7	87.5	1	13.5	0	0
	Gjithsej	395	232	58.73	151	38.23	4	1.01

Për të parë dallimet ndërmjet funksionimit dhe jo funksionimit të KSHMDF shkallën e funksionimit përkatësisht të mos funksionimit të këtyre strukturave shumë të rëndësishme të mbrojtjes dhe të promovimit të drejtave të fëmijës bëjmë paraqitjen grafike të diskrepancës ndërmjet tyre(Gr. 6)

Në procesin e kryqëzimi të rezultateve kemi arritur në përfundim se në shumicën e shkollave të Kosovës funksionojnë KSHMDF. Kjo është një gjë mirë, sepse funksionimi i këtyre komiteteve, nuk ka pas një mbështetje të mjaftueshme nga institucionet e jashtme(DKA, MASHT, OJQ-të etj). Kur përmendet mbështetja mendohet në monitorimin e punës së tyre, në sigurimin e kushteve më të mira të punës, në organizimin e procesit të fuqizimit nëpërmjet trajnimeve, përkrahjen materiale morale, etj.


Motivet kryesore të punës së KSHMDF kanë qenë rezultatet e arritura, kreacioni dhe vendosmëria e udhëheqjeve shkollore dhe e këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës - **KMDF**

Gr.6. Dallimi ndërmjet funksionimit dhe jo funksionimit të KShMDF



Hapin e parë që duhet që duhet ndërmarr është themelimi i KSHMDF në institucionet arsimore në të cilat këto komitete nuk funksionojnë

Gr.7. Përqindja e funksionimit të komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shkollat e Kosovës



3.3.2. Si vlerësohet puna e KSHMDF nda mësimitdhënësit dhe drejtorët ?


Në hulumtim, pos që kemi dëshiruar të konstatojmë se a funksionojnë KSHMDF apo jo, kemi dëshiruar të konstatojmë si vlerësohet puna e KSHMDF nga mësimitdhënësit dhe drejtorët. Vlerësimi i punës së KSHMDF është bërë me nota duke filluar nga nota “5” që bënë vlerësimin më të lartë(jashtëzakonisht i rëndësishëm për fëmijë dhe për punën e shkollës) deri te nota “1” (i pa rëndësishëm dhe i pa dobishëm si për nxënës ashtu edhe për punën e shkollës). Këtë vlerësim e kanë **dhënë 87 mësimitdhënësit** (gjashtë mësimitdhënësit nuk janë përgjigjur në pyetje) dhe **8 drejtorë të shkollave urbane** në shtatë rajone të Kosovës. Vlerësimin e punës së KSHMDF e paraqesim në Tabelën 3.

Nga tabela 3 shihet qarë se puna e KSHMDF si nga mësimitdhënësit ashtu edhe nga drejtorët vlerësohet shi shume dobishme. Grafiki kështu këto vlerësime bëhen edhe më të qarta në Gr.8

T-4. Vlerësimet e mësimitdhënësve dhe e drejtorëve të shkollave për rolin dhe rëndësinë e KSHMDF

Nr	Vlerësuesit	Gjithsej	5	4	3	2	1	Nota mesatare
1	Mësimitdhënësit	87	48	18	6	4	11	4.2
2.	Drejtorët	8	5	2	1	0	0	4.5
3.	Gjithsej	95	53	20	7	4	11	4.2

Gr.8. Vlerësimi i punës së KShMDF nga mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave



Siç në garfikun 8, ashtu dhe në T-3, shihet qartë se puna e **KSHMDF vlerësohet si shumë e dobishme dhe e domosdoshme**, si për nxënësit, ashtu edhe për shkollën. Nga T-3 dhe në Gr.8 vërehet një dallim i vogël në vlerësimin e punës së KSHMDF nga drejtorët dhe mësimitdhënësit. Drejtorët kanë për disa nuanca vlerësim më lartë se mësimitdhënësit për punën e KSHMBDF, por ky dallim statistikiisht nuk është i rëndësishëm, që do të thotë se po të bënim një hulumtim në tërë popullacionin, dallimi nuk do të evidencohej dhe kushtëzohej me funksionin e drejtorit apo të mësimitdhënësit.

3.3.3. Çfarë propozojnë mësimitdhënësit për avancimin punës së KSHMDF

Në hulumtimin shpejtë kemi dëshiruar të marrim edhe mendimet dhe propozimet e mësimitdhënësve lidhur me masat që duhet të ndërmerren për avancimin e punës së KSHMDF. Propozimet e mësimitdhënësve për avancimin e punës së KSHMDF paraqiten në T- 4.

Këto propozime argumentojnë dhe forcojnë bindjen e fituar se **KSHMDF nuk e kanë pasur përkrahjen e duhur nga institucionet kompetente, por ehe nga shoqëria civile si dhe nga vetë ideatorët e formimit të kësaj strukture (KEC), që nduk do të duhej të ndodhë në të ardhmen, sepse kjo strukturë është një shtyllë e fuqishme e maksimalizimit të efikasitetit dhe të efektivitetit të punës së sistemit të arsimit të Kosovës.**

T-5. Propozimet e mësimitdhënësve për avancimin punës së KShMDF

Nr	Përshkrimi i propozimeve të mësimdhënësve për avancimin KShMDF	GJINIA +NUMRI + PËRQINDJA				Gjithsej	
		Femra		Meshkuj		Numri	%
		Numri	%	Numri	%		
1.	Më shumë angazhim, më shumë mbledhje(së paku 12 mbledhje brenda vitit shkollor, me plan veprimi)	7	8.54	3	3.66	10	12.19
3.	Bashkëpunim më të madh(brenda shkollës zonës, rajonit. Plan veprimi për bashkëpunim)	13	15.85	8	9.76	21	26.61
2	Me shumë debate dhe diskutime (seminare, ligjërata, ekspozita)	19	23.17	9	10.98	27	32.93
3.	Monitorimi dhe vlerësimi i punës së KShMDF	6	7.32	5	6.10	11	13.41
4	Stimulimi, inkurajimi dhe krijimi i kushteve të punës	5	6.10	2	2.44	7	8.54
5.	Formimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik	3	3.66	1	1.22	4	4.88
		53	64.63	29	34.94	82	100


Rëndësinë e këtyre propozimeve për avancimin punës së KSHMDF e vlerësojmë sipas numrit të mësimdhënësve dhe të drejtorëve që e kanë deklaruar propozimet e këtilla. Kjo do të thotë, sa më shumë mësimdhënës dhe drejtor që e kanë propozuar një masë të caktuar, aq më relevante është ajo masë për avancimin e punës së KSHMDF.

Relevancën e propozimeve e paraqesim në rangun 1

Rangu	PROPOZIMI	NUMRI	%
I.	Organizimi i më shumë debateve dhe të diskutimeve; mbajtja e më shumë ligjëratave, trajnimeve organizimi i ekspozitave për gjendjen e të drejtave të fëmijës	27	32.93
II.	Bashkëpunim më i madh brenda shkollës (KSHMDF-KMDF-mësimdhënës-Këshilli i Shkollës,prindër); jashtë shkollës(shkollat e komunës, rajonit, Kosovës)	21	26.61
III	Monitorimi dhe vlerësimi i punës së KSHMDF	11	13.41
IV	Më shumë angazhim, më shumë mbledhje (12 mbledhje në vit, plan veprimi njëvjeçar)	10	12.19
V.	Krijimi i kushteve më të mira, stimulimi inkurajimi	7	8.54
VI	Formimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik	4	4.88

Relevanca e propozimeve paraqitet në Gr.9.

Gr.9. Paraqitja grafike e relevancës së propozimeve të mësimdhënësve për avancimin KShMDF



Legjenda:

MSHA- Më shumë angazhime, më shumë mbledhje, plan veprimi (12 mbledhje në viti)

BMM - Bashkëpunim me mësimdhënës , me KSHMDF, me OJQ, organe, media

MDD - Më shumë debate dhe diskutime(më së paku 6 debate në vit, për shkollë)

MVP - Monitorimi dhe vlerësimi i punës së komiteteve shkollore

SKK - Stimulum , krijimi kushteve dhe inkurajim i punës së komiteteve

FSHP – Formimi i shërbimeve pedagogjike - psikologjike në shkolla

3.4. Roli, rëndësia dhe përdorimi i Kutisë për të Drejtat e Fëmijës- KTDF


Kutia për të Drejtat e Fëmijës (**KTDF**) është po ashtu një adresë e shkëlqyer për evidentimin dhe adresimin e shkeljes së drejtave të fëmijë në institucionet e arsimit. **KTMD** mund të jetë faktorë i rëndësishëm për parandalimin e dhunës, zvogëlimin shkeljes së drejtave të fëmijës , rritjen e transparencës së punës së mësimdhënësve dhe të subjekteve të tjera në shkollë. Po kështu, **KTDF** mund të jetë instrument i rëndësishëm për hulumtimin dhe vlerësimin se sa mjediset shkollore janë të sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore për fëmijë. Duke e ditur rolin **KTDF** me projektin:”Edukimi për të Drejtat e Fëmijës” të cilin e ka realizuar Qendra për Arsim e Kosovës – KEC në bashkëpunim me MASHT-in në periudhën 2004-2006 në shumicën shkollave qe vendosur **KTDF**.

Me VSH kemi pas për qëllim të vlerësojmë shkallën e funksionimit të **KTDF** dhe vlerësimet që nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët kanë për to.

Vendosja e **KTDF**, nuk ka është bërë në shumë shkolla , me arsyetimin e drejtorëve se aty mund të ketë dhe keqpërdorime, kritika jo konstruktive, të pavërteta dhe thashetheme. Megjithatë, kjo nuk është ashtu , sepse për secilin konstatim, vërejtje dhe sugjerim, qoftë ai i vërtetë ose i rrem do të bëhej një vlerësim i argumentuar. Të gjitha ato që janë tendencioze , të pavërteta, që kanë karakterin e paragjyqimeve, stereotipave dhe të “izmave” duhet të jenë pjesë e debateve, diskutimeve dhe të

ndryshimeve, sepse këto anomali që veprojnë nën “plaf” helmojnë marrëdhënie, rrisin pasigurinë, nxisin dhunën në institucionet arsimore. Vendosija e KTDF është një adresë shumë e mirë për ata që nuk e kanë guximin që të shprehin pakënaqësitë e arsyeshme, padrejtësitë dhe shkeljet e të drejtave të fëmijës dhe të njeriut në institucione arsimore. Me gjithë rezervat që disa drejtorë shkollash dhe ndoshta edhe ndonjë mësimdhënës kanë për vendosjen e KTDF-së, vlerësime e drejtorëve për vendosjen e tyre janë shumë afirmative sepse 87,5 % të drejtorëve kanë deklaruar se KTDF janë shumë të dobishme, dhe vetëm 12,5 % kanë deklaruar se janë pjesërisht të dobishme. Këto opinione paraqiten në Gr.9.

Gr.10. Opinionet e drejtorëve të shkollave për dobinë e KTDF



Ajo që duhet bërë që KTDF të jetë jo vetëm adresë për paraqitjen e të gjitha shkeljen të drejtave të njeriut dhe të fëmijë në shkolla dhe në institucionet arsimore është që ato të mos vendosen sa për sy e faqe dhe të kenë karakter formal. Para se vendosjes së tyre duhet të zhvillohet në debat për qëllimet, dobitë dhe funksionin e KDF. Më pas duhet hartuar një rregullore të shkurtë për shfrytëzimin saj dhe parandalimin mundshëm të përdorimit të saj për qëllime personale.

3.5. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve- këshilltarë për të drejtat e fëmijës-KMDF në institucionet arsimore

Me projektin “Edukimi për të drejtat e fëmijës” është paraparë që mbi 1 200 mësimdhënës të arsimit fillor dhe të mesëm të përfshihen në trajnime për këshilltarë për të drejtat e fëmijës. Puna e këshilltarëve për të drejtat e fëmijë është treguar shume e suksesshme, andaj janë shtruar kërkesat për rritjen e numri të tyre. Tani në Kosovë janë mbi 1400 këshilltarë⁵ Të gjithë këta këshilltarë janë përfshirë edhe në projektin SCREAM - të Përkrahim të Drejtat e Fëmijës përmes Edukimit, Artit dhe Medias(PDFPEAM) që është realizuar nga KEC në bashkëpunim me UNICEF-in, ILO-n dhe IPEC-un në vitin 2007.

Nëpërmjet projektit :” Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla” , UNICEF dhe KEC synojnë të fuqizojnë këtë strukturë të tretë e cila

⁵ Shih veb faqen: www.chlidrights-ks.org

po ashtu, jo vetëm që është një adresë e shkëlqyer për evidentimin shkeljeve të drejtave të fëmijës, por është edhe digë e fuqishme për mbrojtjen dhe avancimin drejtave të fëmijës dhe krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla. Por për të fuqizuar rolin tyre, keni dashur të bëjmë një vlerësim të shpejtë të punës së tyre.

Nëpërmjet intervistave telefonike, teknikës së “topave të dëborës” dhe të pyetësorëve për mësimdhënës kemi konstatuar shkallën e shpërndarjes së tyre nëpër shkolla, si dhe vlerësimet e drejtorëve dhe të mësimdhënësve për punën tyre.

T-6. Vlerësimet e mësimdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KSHDF


Nr	Vlerësuesit	Gjithsej	5	4	3	2	1	Nota mesatare
1	Mësimdhënësit	87	48	13	7	13	6	3.7
2.	Drejtorët	8	3	4	1	0	0	4.2
3.	Gjithsej	95	51	17	8	17	6	3.9

Vlerësimet e mësimdhënësve dhe të drejtorëve për punën KMDF edhe pse janë diçka më të ulëta se sa vlerësimet për punën e KSHMDF, megjithatë janë shumë të mira. Kjo shihet më qartë në grafikun 12. Me projektin : **Krijimi i mjediseve të sigurta, jo dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla.**

Në 183 shkolla sa janë përfshirë në vlerësim të shpejtë kemi konstatuar se në Fushë Kosovë asnjë këshilltarë nga pesë shkolla të përfshira në hulumtim nuk e kryen detyrën e këshilltarit për të drejtat e fëmijës. Po ashtu, në dy shkolla të komunës së Rahovecit të përfshira në hulumtim nuk funksionojnë, përkatësisht këshilltarët për të drejtat e fëmijës nuk e kryejnë detyrën e këshilltarit. **Gjatë vlerësimit të shpejtë kemi konstatuar se këshilltarët për të drejtat e fëmijës më pak janë të aktivizuar në vendbanimet rurale. Nga 183 shkolla në të cilat është organizuar hulumtimi në tetë shkolla rurale (2 në Dragash- Sharr, pesë në Fushë Kosovë, dhe 1 në Rahovec).** Në shkollat në të cilat kemi zhvilluar hulumtimin kemi konstatuar se në vendbanimet urbane punojnë 240 apo 59.55% këshilltarë për të drejtat fëmijës dhe në vendbanimet rurale 163 ose 40.45%. Kjo gjendje paraqitet në Gr.11


Në grafik shihet qartë se pjesa dërmuese e drejtorëve dhe mësimdhënësve me notë të shkëlqyer ose shumë të mirë e vlerësojnë punën e Këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Megjithatë, **ne jemi të bindur se sikur KMDF do të monitoroheshin më shumë dhe të gëzonin më shumë përkrahje nga drejtoritë e shkollave, organet kompetente lokale dhe qendrore jo vetëm që efikasiteti dhe efektiviteti i punës së tyre do të ishte shumë më i lartë por edhe do kishim mjedise shumë më të sigurta shumë më pak të dhunshme dhe me shkallë shumë më të lartë të efektivitetit të shkollave dhe të institucioneve arsimore.**

Gr.11. Përqindja e këshilltarëve që veprojnë në shkollat urbane dhe rurale



Në hulumtim kemi dëshiruar të marrim edhe opinionet e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KShMDF. Vlerësimet e tyre për punën e KMDF paraqiten në T-4

Gr.12. Vlerësimet e mësimitdhënësve dhe të drejtorëve për punën e KShMDF



3.5.1. Çfarë propozojnë mësimitdhënësit për avancimin punës së Këshilltarëve për të drejtat e fëmijës?

Në vlerësimin shpejtë i kemi marrë propozimet e mësimitdhënësve **për avancimin e punës së këshilltarëve për të drejtat e fëmijës**. Propozimet e mësimitdhënësve për avancimin e punës së këshilltarëve për të drejtat e fëmijës paraqiten në T-6.


Siç shihet në T-6 mësimitdhënësit i kanë dhënë disa propozime të vlefshme, respektimi dhe zbatimi i të cilave do të ndihmonte që të rritet efikasiteti dhe efektiviteti i **KMDF në krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane / miqësore për fëmijë**. Në zbatimin projektit: *“Krijimi i mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme dhe humane / miqësore në shoqëri dhe në shkolla”*, propozimet e këtilla do të merren parasysh.

Në grafikun nr. paraqitet edhe përqindja e frekuencave të propozimeve të tilla.

T-7. Tabela e propozimeve të mësimdhënësve për avancimin e punës së KShDF

Nr	Përshkrimi i propozimeve të mësimdhënësve për avancimin KSHMDF	GJINIA +NUMRI + PËRQINDJA				Gjithsej	
		Femra		Meshkuj			
		Numri	%	Numri	%	Numri	%
1.	Më shumë angazhim, më shumë mbledhje(me shumë ligjërata, më shumë aktivitete, monitorime më të shpeshta) - AMM	6	8.82	4	5.88	10	14.71
2.	Me shumë debate, këshillime dhe diskutime - DK	5	7.35	3	4.41	8	11.76
3.	Trajnime dhe zhvillime profesionale TZHP-	10	14.71	9	13.28	19	27.94
4.	Mbështetja nga institucionet jashtëshkollore- MIJ	7	10.29	3	4.41	10	14.71
5.	Stimulimi, inkurajimi dhe krijimi i kushteve të punës. Lokal i veçantë SIK	8	11.76	3	4.41	11	16.18
5.	Organizim i seminareve për të drejtat e fëmijës në shkollë - OSDF	3	4.41	0	0	3	4.41
6.	Të marrin masa rehabilituese me fëmijë asociale - MRSA	4	5.88	0	0	4	5.88
7.	Respektim më të madh të rregullave shkollore RMRr	2	2.94	0	0	2	2.94
8.	Themelimi i shërbimeve psikologjike ThShP	1	1.47	0	0	1	1.47
	Gjithsej	46	67.74	22	32	68.35	

Gr. 13. Paraqitja grafike e propozimeve të mësimdhënësve për avancimin e punës së KShMDF



Siç shihet në T-6 dhe në Gr.13 numri më i madh i mësimdhënësve me qëllim të avancimit të punës së këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijë ka të bëjë zhvillimin e trajnimeve dhe me zhvillime profesionale. Me fjalë të tjera fuqizimi i këshilltarëve është detyrë prioritare sipas mendimit të mësimdhënësve. Propozimi i dytë ka të bëjë mbështetjen dhe inkurajimin e **KMhMD** nga institucionet jashtëshkollore.

3.6. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë, në sytë e nxënësve kosovarë

Në hulumtimin shpejtë kemi dëshiruar të konstatojmë edhe gjendjen e të drejtave të fëmijës nga këndi i perceptimit të tyre. Për këtë qëllim i kemi anketuar **204 nxënës të moshës 13,14 dhe 15 vjeçare.**

3.6.1. Nxënësit e frikësuar

Në vlerësime e shpejtë kemi dëshiruar të konstatojmë sa nxënësit e kësaj moshe pa shqetësime dhe pa frikë shkojnë në shkolle dhe kthehen parapa. Pas analizës së rezultateve kemi konstatuar se mbi 9% të nxënësve të përfshirë në hulumtim deklarojnë se kanë frikë. Kjo përqindje e nxënësve të deklaruar në mostër duket e vogël, për nëse këtë përqindje e përgjithësojmë në popullacionin e nxënësve të kësaj moshe del shumë e madhe dhe në aspektin statistikor shumë indikative dhe e rëndësishme, sepse aproksimalisht thënë mbi 20.000 nxënës të Kosovës kanë frike dhe shqetësime në relacionin shkollë shtëpi dhe anasjelltas. Kjo përqindje në disa pjesë dhe territore mund të jetë shumë më e madhe, si p.sh. në vendbanime rurale ku nxënësit duhet të udhëtojnë rrugën më të gjatë se 4 kilometra; në vendbanimet me relacione të tensionuara etnike, pjesa veriore e Mitrovicës, etj.

Në hulumtim kemi dashur të konstatojmë nga kush më së shumti nxënësit kanë frikë? Nxënësit në këtë pyetje përgjigjen se frikë kanë nga:

- huliganët (të cilët nga kërkojnë para dhe materiale tjera nga fëmijët) (35.29%)
- Mësimdhënësit (23.53%)
- Bashkëmoshatarët (23.53%)
- Mungesa e rrethojës shkollës (5.88%)
- Drejtori (5.88%)

f. Testet (5.88%)

3.6.1.2. Shumë mjedise të pa përshtatshme, jo higjienike, jo shëndetësore dhe jomiqësore për fëmijë


*“ Në fillim njerëzit i ndërtojnë godinat e më vonë godinat përcaktojnë sjelljen e njeriut”
W.Churchil*

Në studimet meta-analitike është konstatuar se pamja fizike e objekteve ka rëndësi të madhe për zhvillimin e moralit dhe edukimin dhe formimin fëmijëve. Po këtë konstatim e thotë edhe njeri ndër njerëzit me gjenial i shekullit XX, Winston Churchill. Në studimet meta-analitike është konstatuar se objektet me pamje jo të mirë dhe jotërheqëse të nxënësit ndikojnë keq, sepse e zhvillojnë vandalizmin apo ndjenjën për të thyer.

Pamja e më shumë se 70% e shkollave të Kosovës nuk janë tërheqëse dhe në aspektin estetik nuk janë të bukura. Pamja e këtyllë ka ndikim negativ në edukimin dhe arsimimin cilësor dhe të zhvillimi të përgjithshëm të fëmijëve tanë. Me fjalë të tjera objektet dhe mjediset e këtylla cenojnë të drejtat e fëmijës, meqë janë mjedise jo të sigurta, të dhunshme dhe jo humane.

Pastërtia e objekteve dhe e mjediseve shkollore është kusht për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtës shëndetësore të fëmijëve dhe të nxënësve të Kosovës. Por kjo e drejtë për nxënësit e Kosovës sipas këtij vlerësimi lënë shumë për të dëshiruar, sepse nga 204 nxënës të anketuar 101 apo 49.5% të nxënësve kanë deklaruar se nuk janë të kënaqur me pastërtinë që mbretëron në shkolla. Kjo shihet qartë në G.12

Gr.14 .Vlerësimet e nxënësve sipas gjinisë për pastërtinë e objekteve shkollore



Në Gr. 14 shihet se nga 204 nxënës të anketuar 103 apo 50.5% të nxënësve deklarojnë se janë të kënaqur, 101 apo 49.5% janë deklaruar se nuk janë të kënaqur dhe 1 apo 0.5% nuk është përgjigjur në këtë pyetje. Po ajo që shihet në grafik dhe që është interesante, është se **gjinia femërore është shumë më e pakënaqur me pastërtinë** se sa gjinia mashkullore., sepse **deri sa 56.45 % nxënësve nuk janë të kënaqur me pastërtinë e mjediseve shkollore, tek gjinia mashkullore kjo përqindje është 45 ose 48.39% .**

Ajo që shqetëson është se nga 204 nxënës të anketuar 101 apo 49.5% nuk janë të kënaqur me higjienën në shkolla.

3.6.2. Mjediset shkollore në Kosovë ende nuk janë mjedise jo të dhunshme!!!

Dhuna e tashme në mjediset edukative dhe shkollore - pengesë e madhe për ndryshime më pozitive dhe më dinamike pozitive në shoqërinë kosovare

Autori i raportit

3.6.2.1. Pak fjalë për fenomenin e dhunës në Kosovë

Dhuna është një çështje komplekse. Arritjet e deritashme shkencore nuk kanë mund t'i shpjegojë të gjitha a përmasa e saj. Për këtë arsye ende nuk e kemi një përkufizim të plotë dhe për të gjithë të pranueshëm për dhunën. Në teorinë për dhunën janë evidentuar mbi 50 përkufizime⁶.

Unë, personalisht, kam më shumë preferenca për përkufizimin Johan Galtungut i cili me dhunë nënkupton: "...ndikimi negativ në nevojat themelore (bazike) të njeriut(ose jeta) jeta të cilës mund t'i shmangemi dhe që kufizon mundësinë potenciale për kënaqjen e këtyre nevojave". Kërcënim me dhunë është dhunë, indiferenca, moskujdesi, mospërfillja, varfëria janë dhunë sepse pengojnë plotësimin apo kënaqjen e nevojave tona bazike. Nevojat tona bazike janë:

- ✚ Ekzistenca – mbijetesa
- ✚ Shëndeti dhe furnizimi me ushqim të shëndetshëm, ujë të pijshëm , ajër të pastër
- ✚ Identiteti
- ✚ Rrita dhe zhvillimi
- ✚ Liria

Unë me dhunë nënkuptoj: të gjitha kushtet dhe rrethanat në të cilat individit i pamundësohen të zhvillojë potencialet e veta gjenetike, fiziologjike , fizike , mentale , emocionale dhe sociale. Thënë më qartë dhunë është çdo akt dhe veprim apo edhe mosveprim me të cilën pamundësohet zhvillimi i njeriut deri aty ku Zoti ka thënë se mund të zhvillohet. Meqë ky ideal i lartë asnjë herë nuk do të mund të plotësohet, del përfundimi se dhuna do jetë pjesë përcjellëse e zhvillimit të njeriut. Por ajo çfarë duhet bërë është që disa forma të dhunës të evitohen (p.sh. dhuna fizike, dhuna psikike që synon atakimin e dinjitetit të njeriut, varfëria që pengon zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut etj.).

Në anën tjetër, ekzistojnë lloje të ndryshme të dhunës. Edhe për llojet e dhunës nuk ekziston një klasifikim i pranuar nga të gjithë. Në teorinë mbi dhunë sot ekzistojnë mbi dhjetëra klasifikime të dhunës. Kështu sot flitet për dhunën strukturore dhe dhunën drejtpërdrejtë. Dhuna strukturore është ajo dhunë ushtruesi i të cilës nuk dihet. Dhunë strukturore është kur sistemi i arsimit nuk është efikas dhe efektiv dhe si i tillë pengon zhvillimin e individit dhe të shoqërisë që të vetë-realizohet. Mos përgatitja e

⁶ Në hulumtimin e zhvilluar nga UNICEF konstatohet se në Kosove kishte probleme me përkufizimin e dhunës. Në këtë hulumtim ndërmjet tjerash konstatohet: "shumë fëmijë më të vegjël nuk ishin në gjendje përkufizonin dhunën. Ata që mundën ta bëjnë këtë, zakonisht e lidhnin me dhunën fizike. Më të rriturit flisnin për dhunën fizike ,por shtonin edhe dhunën emocion, për të cilin thoshin se mund të marr shumë forma. Fëmijët më të rritur duket se ishin të prekur nga padrejtësia dhe se e kishin të vështirë ballafaqoheshin m fyerjen, frikësimin dhe nënçmimin. Në masë e madhe e arsimitarëve nuk ishin në gjendje të përkufizonin dhunën kur pyeteshin në mënyrë individuale, ndonëse nga diskutimet në grupet e synuara ka dal një përkufizim i synuar(UNICEF ,2005 , Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës, f. 41)

mësimdhënësit dhe mos-zotërimi i kompetencave të duhura për zhvillimin efikas dhe efektiv të mësimdhënies është dhunë strukturore. **Mungesat dhe vonesat e mësimdhënësve në orë të mësimi, janë dhunë strukturore. Udhëheqja jo efikase dhe jo efektive e shkollës është dhunë strukturore mbi nxënës. Pamja jo tërheqëse, jo higjienike e objekteve shkolle është dhunë strukturore. Kjo formë e dhunës që ushtrohet mbi nxënës dhe fëmijët tanë është dhuna më e rëndë sepse të gjitha llojet tjera të dhunës të cilat si tentakulat- pipthat- zgjatime të oktapodit burojnë nga dhuna strukturore.**

Për fat të keq, sot rrallë kush në Kosovë, merret me këtë lloje dhune, pa evitimin saj nuk do të mund të evitohen edhe llojet tjera të dhunës së drejtpërdrejtë(dhuna fizike, psikike-emocionale, shpirtërore,orale, sociale, eksplicite, implicite etj.) burojnë nga kjo dhunë.

Ne, megjithatë, në këtë në vlerësim nuk e kemi përfshirë dhunën strukturore, por dhunë fizike dhe orale(fyerjet dhe ofendimet dhe përçmimet) etj.

Dhuna strukturore e përhapur gjithandej në shoqërinë kosovare bën që mjediset shoqërore dhe shkollore të konsiderohen si të dhunshme. Ky konstatim dëshmohet edhe në rezultatet e hulumtimit që do të prezantohen në vazhdim..

3.6.2.2. Edhe pse dhuna e mësimdhënësve ndaj nxënësve ka shënuar rënie, dhuna fizike mbi nxënës është në rritje dhe shqetësuese⁷

Nga 203 nxënës që janë përgjigjur në pyetjen a është përdorë dhuna fizike ndaj jush, **34 apo 16.4 % kanë deklaruar se ndaj tyre përdoret dhuna fizike**(një nxënës nuk është përgjigjur në pyetje). Kjo rritje e përqindje së përdorimit të dhunës është rezultat i rritjes së i keqtrajtimit(**me keqtrajtim nënkuptohet përdorimi më shumë se një herë i dhunës ndaj personit- viktimës nga ushtruesi i dhunës**) të fëmijëve nga a fëmijët moshatarë apo BULLYING-ut

Me qëllim që të konstatojmë se përkatësia gjinore a ka ndikim në ushtrimin dhunës kemi bërë analizën e dhunës së ushtruar mbi bazën e përkatësisë gjinore. Ushtrimi i dhunës mbi nxënës mbi bazën përkatësisë gjinore e paraqesim në T- 7

T-8. Përdorimi i dhunës mbi nxënës në aspektin gjinor


Nr.	Përdorimi i dhunës	GJINIA				Gjithsej	
		Femra		Meshkuj			
		Numri	%	Numri	%	Numri	%
1.	Po	9	4.4	25	12.31	34	16.6
2.	Jo	101	49.50	68	33.39	169	83.25
3.	Pa përgjigje	1	0.5	0	0	1	0.5
	Gjithsej	110	53.9	93	45.59	204	100

⁷ Në hulumtimin e cituara të UNICEF-it del një konstatim të cilin ne në hulumtimin tonë nuk e kemi vërtetuar. Në këtë hulumtim në mes tjerash thuhet: Arsimitarët besojnë se dhuna e shkaktuar nga arsimtarit ndaj fëmijëve është mjaft e rrallë dhe e kufizuar vetëm në keqtrajtim verbal(këtu nuk shpjegohet përmbajtja e konceptit keqtrajtim: v.-H.Huseni). Megjithatë, ata besojnë se dhuna është e shpeshtë në shkolla dhe se dhuna në bashkësinë e tyre është shtuar gjatë viteve të fundit(Raporti i cit. f.41). Në hulumtimin tonë kemi konstatuar se dhuna fizike dhe ajo emocionale - shpirtërore ka ra si rezultat i ngritjes së vetëdijes, punës së organeve qeveritare dh të shoqërisë civile, po siç edhe kemi konstatuar në hulumtim dhuna fizike dhe dhuna verbale e bërë nëpërmjet fyerjeve, sharjeve, ofendimeve ka përmasa dhe forma të tjera të cilat forma mjediset i në shoqëri dhe në shkollë i bëjnë me të dhunshme(rritja e delikuencës së miturve, përdorimi i drogës, duhanit dhe të alkoolit, keqtrajtimi i fëmijëve nga fëmijët etj)

Në T- 7 shihet se prej 204 e nxënësve të përfshirë në vlerësim , 203 nxënës janë përgjigjur në pyetjen :”A përdoret dhuna fizike mbi JU?”. Prej 203 nxënësve që janë përgjigjur në këtë pyetje 34 apo 16.6% kanë deklaruar se ndaj tyre ushtrohet dhuna fizike mbi ta , ndërsa 169, apo 83.25% kanë deklaruar se ndaj tyre nuk përdoret dhuna fizike. Përqindja e përdorimit të dhunës së fizike përballë nxënësve ndaj të cilëve nuk ushtrohet kjo formë e kësaj dhune paraqitet në Gr.13.


Nëse këtë numër të nxënësve e gjeneralizojmë në popullacionin e përgjithshëm të nxënësve në arsimin fillor dhe të ulët të mesëm të ulët në Kosove, atëherë del se dhuna fizike ushtrohet në rreth 49.800 nxënës. Kjo shifër e nxënësve mbi të cilët ushtrohet dhuna fizike është shumë shqetësuese dhe tregon se mjediset shkollore janë të dhunshme dhe si të tilla në masë të konsiderueshme ndikojnë në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit në Kosovë.

Gr.15. Paraqitja grafike përqindjes së nxënësve ndaj të cilëve ushtrohet / nuk ushtrohet dhuna fizike



Në hulumtimi kemi dëshiruar të konstatojmë se në përdorimin e dhunës a ka ndikim përkatësia gjinore. Siç shihet në tabelën T-4 dhe në Gr. 14 nxënësit meshkuj më shumë janë objekt i dhunës fizike se nxënëset femra.

Gr.16. Përdorimi i dhunës fizike mbi nxënës sipas përkatësisë gjinore



Në Gr.14 shihet qartë se nxënësi e gjinisë mashkullore tri herë më shumë janë objekt i dhunës fizike se sa nxënëset. Sipas mendimit tonë kjo është rezultat i pozitës dominante të gjinisë mashkullore, e cila është më dinamike, më e lirë në veprime, andaj edhe është në

pozitë që të mos respektojnë të rregullat dhe përgjegjësitë. Në anë tjetër, studimet tregojnë se **vajzat në këtë moshe për shkak të edukimit ende patriarkal në familje janë me të tërhequra dh më të prira për të respektuar rregullat dhe përgjegjësit shkollore andaj ndaj tyre merren më pak veprime represive.**

Në hulumtim të shpejtë , po ashtu kemi dëshiruar të konstatojmë se kush përdor më shumë dhunë ndaj nxënësve meshkuj dhe nxënësve- vajzave.

Ushtruesit dhe përdoruesit e dhunës fizike mbi nxënës dhe nxënës - vajza paraqiten në T-8

Në T-8 janë paraqitur disa rezultate interesante që mund të thuhet se janë një lloje befasie për autorin e këtij studimi.

E para, krahasuar me vitin 2003 dhuna fizike që mësimitdhënësit kanë përdor ndaj nxënësve është zvogëluar për **5.6 %**.

E dyta, deri se në një shënohet një **zvogëlim i dhunës fizike e mësimitdhënësve ndaj nxënësve** , kemi një **rritje rapide të dhunës fizike të bashkëmoshatarëve ndaj nxënësve** , apo të keqtrajtimit i fëmijëve nga fëmijë moshatarë. Në total kjo përqindje është 5.4% . Nëse nuk merren masa preventive shkalla e kësaj dhune do të rritet jashtëzakonisht shume. Këtë lloj dhune e kanë nxitur teknologjia,informative, mos-atraktiviteti i mësimitdhënies , rënia e rolit edukativ të shkollës etj.

T-9. Ushtruesit- përdoruesit e dhunës mbi nxënës dhe nxënës- vajza në Kosovë

Nr.	Ushtruesit e dhunës	Viktimat sipas gjinisë				Gjithsej	
		Femra		Meshkuj		Numri	%
		Numri	%	Numri	%		
1.	Babai	0	0	1	2.9%	1	2.9%
2.	Nëna	3	8.8%	3	8.8%	6	15.5%
3.	Mësimitdhënësit	4	11.8%	8	23.5%	12	35.3%
4.	Bashkëmoshatarët	2	5.9%	13	38.2%	15	44.1%
	Gjithsej	9	26.5%	25	73.5	34	100


E treta, vetëm në 2 raste **apo 5.9% kemi has në përdorim të dhunës** , apo të keqtrajtimit të femrave nga moshatarët . Andaj ky lloj keqtrajtimit, së paku në Kosovë akoma (bullying-ut)⁸ siç tregon hulumtimi, ka karakter - përmasë mashkullore.

⁸ Olweus (1998) keqtrajtimitin e fëmijëve nga fëmijët moshatarë e përkufizon si:” shumë të veprimeve të qëllimshme negative që janë afatgjatë, të orientuar në të njëjtën nxënës nga një nxënës ose grup(më së shumti 2-3 nxënës) .Ne veprimet negative përfshihet dhuna fizike dhe /ose dhuna psikike, si dhe izolimi. Raporti keqbërësit- ushtruesit të dhunës dhe të viktimitës gjithnjë është i përcjell me një pa barazpesh në boshtin mundësi(forcë) – pamundësi (mungese e forcës) (shih mëgjersishtisht: Unicef Priručnik. Stop nasilju među decom.Projekat ZA SIGURNO I POTENCIALNO OKRUŽENJE U ŠKOLAMA. Prevencija i borba protiv nasilja među djecom (2003- 2005, f.12) Ken Rigby, një ekspert australian për BULYING-n ka analizuar shumë përkufizime të këtij fenomeni dhe mbi bazën e analizave të bëra ka arritur bullying-un ta përkufizojë si:”... **dëshirën e dikujt që dikend ta lëndojë: veprim i lëndimit+ pa barazpesha e fuqisë + (në parim) përsëritje e sjelljes+ përdorim jo drejt i përdorimit të forcës + kënaqësia e dukshme e**

E katërta, në familje ushtruesi më i madh i dhunës është nëna. Siç shihet, në grafikun 15 dhe, në T-8 nëna nuk bënë” diskriminim” në ushtrimin e dhunës kur është në pyetje përkatësia gjinore .Edhe këtu, siç është konstatuar edhe në hulumtimin e zhvilluar nga **KEC në vitin 2005, në familje ushtruesi më i madh i dhunës është nëna**⁹.

Intensiteti i dhunës ushtruar sipas gjinisë dhe ushtruesve të dhunës paraqitet në Gr.15. Siç shihet në Gr.15 nëse shikohet dhuna mbi nxënës meshkuj atëherë bëhet e qartë se dhuna me e madhe që ushtrohet mbi gjininë mashkullore është keqtrajtimi i fëmijëve nga fëmijët moshatarë, të cilët gjithnjë e më shumë janë duke bartë armë të rrezikshme (brisqe thika, shufra metali dhe druri dhe armë zjarri). Këto ditë në Prishtinë humbi jetën një fëmijë 13 vjeçar të cili për t'u tallur ia kishte vendosur revolen në kokë tjetër i moshës 20 vjeçare, e cila shkrep dhe ne vend la pa jetë fëmijën 13 vjeçar . Që tragjedia të jetë edhe më e madhe në burg djalli qe kishte marrë një jetë duke u tallur gjen mënyrë për t'u vetëvrasë. Ndodhi çka ndodhi dhe ngjarja u harrua. Askush as policia, sa organet përgjegjëse, as OJQ se bashku me shoqërinë civile nuk u shqetësuan për këtë çështje, ani pse rasti është nuk është i vetmuar, lëndime me thike nga bashkëmoshatarët janë shpeshtuar aq shumë sa janë për shqetësim dhe për këtë do të duhej të diskutojë parlamenti i Kosovës . Sot po thuaj se nuk ka shkollë në të cilat nxënësit nuk marrin armë të cilat rrezikojnë jetën e secilit nxënës.

Gr.17. Dhuna e ushtruar mbi nxënës sipas gjinisë dhe ushtruesve të dhunës



Kjo indiferencë ndaj sigurisë së jetës së njeriut është e shqetësuese dhe për të gjitha ata që me pasion merren me të drejtat e fëmijës dhe të njeriut përjetohet si torturë.

Ky vlerësim i shpejt tregon se në mjediset shoqërore dhe publike në përgjithësi dhe në mjediset shkollore në veçanti dhuna fizike, jo vetëm që është prezente por është një karakteristikë tipike, të cilën shoqëri e Kosovës duhet ta luftojë me një

ushtruesit të keqtrajtimit dhe ndjenja nënshtruese e viktimës” (Po aty, f. 12-13, si dhe: <http://www.education.edu.au/bullying/>).

⁹ Rezultatet e këtij hulumtimi në gjuhën serbe janë botuar në Jagodinë, në vitin 2006. Halim Hyseni(2006) Nasilje nda decom u porodici sa aspekta nekih rezultata istraživanja. Kako preduprediti nasilje čoveka nad čovekom.

intensitetet të përshpejtuar (vetëm gjatë muajit janar të këtij viti tre fëmijë kanë humbur jetën dhe disa kanë qenë të detyruar të shtrohen në spitale)

3.6.2.3. Dhuna psikike- shpirtërore mbi nxënës është një shqetësim legjitim i nxënësve kosovarë !!!?

“ Kush nuk din do t’ia thyej eshtrat,ndërsa kush bën zhurmë filloj me veshin, vazhdoj me 10 shuplaka, e mandej s’u tregoj fare”

Kërcënimi i një mësimdhënësi të gjeografisë i bërë në një shkollë urbane(në Prishtinë) në klasën e V-të

Në teorinë mbi dhunën, siç kemi thënë edhe më lartë, ekzistojnë klasifikime të shumta. Kështu pos dhunës fizike flitet për¹⁰:

- a. **dhunën verbale** (gjuajtja e fjalëve, përqeshja, ngucja me , përçmimi, kërcënimi sharja, fyerja, ofendimi etj)
- b. **dhuna psikologjike**(kushtëzimi, dëmtimi i pasurisë, vjedhjet, gjuajtja e gjërave, shikimi kërcënues , përcjellja armiqësore etj)
- c. **dhuna sociale**(anashkalimi, injorimi, përjashtimi nga aktivitetet intrigimi dh bartja e fjalëve- thashethemeve, presioni mbi të tjerët që të mos shoqërohen me fëmijë të tjerë, izolimi etj)
- d. **dhuna fizike** (shtyrje, rrënim, goditje, shkaktim i dhimbjes , pengim fizik mbylja në një hapësirë)

Unë, ttri llojet e para të dhunës i quaj dhunë shpirtërore , sepse, lan gjurmë të thella në shpirt – psikikën e të rinjve, bile- bile, në shumë raste , më shumë se dhuna fizike.

Megjithatë, në vlerësim- hulumtim të shpejtë më shumë **jemi ndal tek ofendimet, fyerjet të cilat u bëhen nxënësve tanë, nga mësimdhënësit-, edukatorët, ata që janë të thirrur të zhvillojnë vetë- respektin dhe vetë-besimin e nxënësve me fyerjet , ofendimet , sharjet e tyre rrënojnë vetë-respektin dhe vetëbesimin nxënësve dhe kështu ata i bëjnë të palumtur, asocial, të pasuksesshëm dhe vështirë të adaptueshëm dhe produktiv në shoqëri.**

Ofendimet janë fjalë “sulmuese “ që shkaktojnë dhimbje shpirtërore dhe fizike. Ato drejtpërdrejt e atakojnë **dinjitetin njerëzor i cili është themel i të gjitha drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të fëmijës. Fyerjet dhe ofendimet janë të palejueshme,** sepse, përdorimi i tyre tenton të **nxisë një thyerje të menjëhershme të paqes shpirtërore dhe të harmonisë ndërmjet njerëzve.** Fjala “sulmuese” është më pak se gjuha e urrejtjes. Gjuha urrejtjes është një shprehje , **jo e fjalëve të thjeshta që poshtëron ose injoron një grup njerëzish bazuar në besimin, etninë, racën ose kritere tjera, pra është shprehje që ulë vlerat shoqërore.** Nga ana thelbësore ka dy elemente përbërëse të kësaj shprehjeje: *e para,* që shprehja e përdorur duhet të jetë kërcënuese ose fyese dhe *së dyti,* shprehja e përdorur duhet të ketë pasur për qëllim urrejtje racore ose të ketë qenë po thuaj për një gjë të tillë (p.sh. “bashkëpunëtorë i shkijeve”)¹¹

¹⁰ Unicef (Priručnik. Stop nasilju redju decom.Projekat ZA SIGURNO I POTENCIALNO OKRUŽENJE U ŠKOLAMA. Prevencija i borba protiv nasila redju djecom (2003- 2005, f.13)

¹¹ Methasani , E & Mushkolaj, G(2002)Edukimi I UNESCO-s për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Fjalor terminologjik i të Drejtave të Njeriut. Terma dhe Shprehje Bazë të të drejtave të Njeriut në Shqip/ Anglisht/ Shqip Tiranë, f. 53 -57

Dinjiteti paraqet tërësinë e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish; apo vetëdije e njeriut për këto vlera apo të drejtat e veta në shoqëri përkatësisht nderimi për vetveten.
Dinjiteti paraqet cilësitë e mira apo vlerat e larta të diçkaje që i bënë ato të çmohen¹²

Dinjiteti i fëmijëve është vlera më e lartë e tij, me çka ai duhet të krenohet, ajo çka fëmijën e bënë të lumtur, ajo që atë e bënë të vlefshëm dhe të çmueshëm. Të atakosh personalitetin e fëmijës do të thotë ta atakosh qenësinë e tij, qenien dhe ekzistencën e tij. Dinjiteti dhe vlerat morale të fëmijëve janë ato që nxënësit i ndërtojnë i shërbejnë si pasqyrë reale për veten, besimin në vete dhe te tjerët, ndjenjat pozitive dhe harenë, entuziazmin dhe lumturinë. Të atakosh dinjitetin e tij do të thotë të atakosh, lumturinë e tij, harenë, ardhmërinë dhe gjithë atë që është e vlefshme te njeriu¹³.

Në këtë studim kemi konstatuar **atakim të madh të dinjiteti të fëmijës nëpërmjet ushtrimit të dhunës shpirtërore.** Një numër jo i vogël i mësimitdhënësve nxënësit e vet i imagjinojnë si kafshë, mu ashtu si i ilustron karikaturisti, Jeton Mikullovc (Viz.1.)

Në hulumtim **83 apo 49.1 % të nxënësve kanë deklaruar se kanë qenë objekt fyerje dhe ofendimi.** Personat që më së shumti i fyejnë , përçmojnë dhe ofendojnë nxënësit janë **ata që këtë fare nuk guxojnë ta bëjnë, e këta janë mësimitdhënësit.** Kjo gjendje paraqitet në T-9.

Pos mësimitdhënësve , nxënësit e përfshirë në hulumtim kanë deklaruar janë ofenduar dhe përçmuar nga: nëna, vëllai, motra , shokët / shoqet, dikush tjetër.

Është interesant se në hulumtim askush nuk ka thënë se ndonjëherë ka qenë i fyer ose i ofenduar nga babai. Sigurisht që një nga shpjegimet e mundshme mund të jetë se baballarët për shkak të angazhimeve më të mëdha (punës, që përsëri tregon për pozitën më të pabarabartë të gruas në shoqërinë kosovare) kanë shumë më pak kontakte , përkatësisht kalojnë më pak kohë me fëmijët andaj dhe nuk përdorin fyerje dhe sharje për fëmijët e tyre. **Ajo që është e evidente është se ofendimet , përçmime , fyerjet dhe sharjet nga nëna dhe motra janë të rralla dhe paraqesin rastësi, që është e kushtëzuar me vetëdijen e shtuar të prindërve.**

Viz. 1. Kështu një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve i shohin nxënësit e tyre (Ilustroi: Jeton Mikullovc)



¹² Fjalor I Shqipësisë së Sotme (2002), Toena, Tiranë, 241

¹³ Hyseni, H (2004): Të drejtat e fëmijës në sytë e nxënësve kosovarë, KEC, f. 77

T-10. Pasqyra e ushtruesve të dhunës psikike mbi nxënës


Nr.	Përçmuesit e nxënësve	Viktimat sipas gjinisë				Gjithsej	
		Femra		Meshkuj		Numri	%
		Numri	%	Numri	%		
1.	Mësimdhënësit	18	21.69	23	27.71	41	49.40
2.	Shokët/ shoqet	14	16.87	13	15.66	24	32.53
3.	Nëna	2	2.41	0	0	2	2.41
4.	Vëllai	4	4.82	0	0	4	4.82
5.	Motra	1	1.20	1	1.20	2	2.41
6.	Dikush tjetër	1	1.20	6	7.23	7	8.43
		40	48.19	43	51.81	83	100

Në T-9 shihet qartë se mësimdhënësit janë ata që më së shumti ushtrojnë dhunë psikike mbi nxënës (49.40%), më pas, pas tyre vijnë shokët dhe shoqet (32.53%). Në tabelë, po ashtu, shihet qartë se nxënësit-meshkuj (27.71%) edhe kur është në pyetje dhuna psikike më shumë janë viktimë se sa nxënëset - vajzat (21.71%)

Ushtruesit e dyte më të mëdhenj të dhunës psikike edhe këtu janë shokët dhe shoqet si për nxënës meshkuj (15.66%), ashtu, edhe për femra (16.87%). Është interesant se këtu shënohet një përqindje më e madhe e dhunës psikike ndaj nxënësve se sa ndaj nxënësve. Megjithatë, ky dallim statistikor nuk është i vlefshëm që do të thotë se përkatësia gjinore nuk ka përcaktuar dallimin e evidentuar, dallimi pra është i rastësishëm.

Për të parë lëvizjen e dhunës psikike varësisht nga ushtruesit e kësaj dhune kemi bërë një paraqitje grafike (shih: Gr. 16)

GR.18. Ushtruesit e dhunës psikike mbi nxënës- meshkuj dhe nxënës-vajzat



Në hulumtimin e bërë kemi konstatuar 37 fjalë dhe shprehje me të cilat mësimdhënësit atakojnë dinjitetin e nxënësve dhe të familjeve të tyre. Fjalët dhe shprehjet me të cilat mësimdhënësit ushtrojnë dhunë psikike dhe dhimbje fizike mbi nxënësit e tyre paraqiten në T-10.

Fjalët dhe shprehjet e tilla atakojnë dinjitetin e nxënësve, nxisin revoltë, ulin besimin tyre ndaj vetes, krijojnë kompleksin e inferioritetit, de-motivojnë nxënësit për punë për punë të suksesshme edukative dhe arsimore krijojnë konflikte ndërmjet nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nxisin sjelljet të ndryshme asociale të cilat më pas kanë ndikim negativ në shkollë, familje, komunitet dhe në shoqëri.

Veprimet e këtilla të mësimdhënësve janë në **kundërshtim me kodin etik të mësimdhënësve dhe me karakteristika deontologjike të profesionit të mësimdhënies.**

Të gjitha këto raste të stigmatizimeve të nxënësve duhet të adresohen në strukturat e caktuara dhe mekanizmat e formuar në institucione arsimore (KSHMDF; KMDF, KTFD, RQ, Këndet e të DF).

Organet kompetente të arsimit, drejtorët e shkollave, komisionet e ndryshme për vlerësim, kujdestarët e klasave, shërbimet pedagogjike dhe psikologjike në shkolla nëpërmjet aktiviteteve të vetëdijesimit duhet të parandalojnë “blasfemitë” e këtilla të cilat lënë gjurmë të pashlyeshme në krijimin vetë-respektit të nxënësve.

Cikli i ndikimit të atakimeve të dinjitetit të nxënësve nëpërmjet fyerjeve dhe të ofendimeve dhe pasojave nga ky atakim paraqitet në Sk- 2.

Sjelljet asociale mund të jenë të ndryshme; tërheqja në vetëvete për shkak të mosbesimit, vetmia dhe izolimi, distresi, fobitë e ndryshme, që më pas kanë ndikim në paraqitjen e sëmurjeve psikosomatike siç janë ulçera, hipertensioni, sëmundjet psikike: maniako-depresive që mund të çojnë deri në vetëvrasje - suicid.

Reagimi tjetër mund të jetë që fëmijët e këtillë për të tërhequr vëmendjen se edhe ata janë këtu, bëjnë veprime për të ra në sy. Në këtë rast, zakonisht, fëmijët e këtillë bëjnë zgjedhje të gabuara, ndaj të cilëve shumica e mësimdhënësve reagojnë me **ndëshkime edhe më të rënda dhe më drastike.** Kjo tek nxënësit nxitë ndjenjën agresivitetit që përfundon me fyerje, apo edhe me përdorim të dhunës. **Kjo rrugë çon drejt delikuentës së miturve e cila siç tregojnë hulumtimet është rritje rapide në Kosovë.** Sigurisht që ky cikël në jetën e përditshme është më kompleks, por ajo që është e sigurt është se mësimdhënësit me atakimin dinjitetit të nxënësve nëpërmjet të mosrespektimit janë përgjegjës për çorientimin e zhvillimit të fëmijëve.

T-11. Fjalët dhe shprehjet me të cilat mësimdhënësit atakojnë dinjitetin nxënësve

Nr.	Fjalët dhe shprehjet	Nr.	Fjalët dhe shprehjet
1.	Budallë, budallicë, i huptë	21.	Lapericë
3.	I huptë	22.	Qorr
4.	Gomar	23.	I poshtër
5.	Magar	24.	Rrugaç
6.	Kafshë	25.	Ti s'vlen për asgjë
7.	Hajvan	26.	Bashkëpunëtorë i shkijeve
8.	Lopë	27.	Të mbyti krejt
9.	Idiot	28.	Ti nuk je për shkollë
10.	Debil	29.	O pusi të marrtë
11.	Maniak	30.	Babain e ke çoban
13.	E trentë	31.	Mshele, çka po i hap sytë si dreq
14.	Psikopat	32.	Nuk je në striptiz në bar
15.	Pis	33.	Je shume e keqe
16.	Dreq	34.	Mos u zgërdhij
17.	Leshkuq	35.	Rrugaç i pamoralshëm
18.	Kryemadh	36.	Kokëbosh
19.	Llapoç	37.	Gojë qerapë
20.	Laper	38.	Kriminel i poshtër

Megjithatë, kur këto fjalë dhe shprehje fyese i krahasojmë me hulumtimin zhvilluar në vitin 2003 ne konstatojmë një përmirësim të konsiderueshëm, sepse në vitin 2003 janë evidentuar 153 fjalë dhe shprehje përçmuese të cilat mësimdhënësit i kanë përdor ndaj nxënësve të tyre¹⁴. Kemi një zvogëlim prej mbi katër herësh. Megjithatë, kjo gjendje akoma është shumë shqetësuese dhe e pa-tolerueshme., meqë mjediset shkollore i bëjnë jo humane dhe jo miqësore për fëmijë sepse fëmijët e atakuar në këtë mënyrë janë të keqtrajtuar. Ky keqtrajtim, ata i bënë me një vetë-respekt të ulët dhe kanë ndjenjë e një pranimi jo të mirë nga moshatarët e tyre, janë të frikësuar, kanë tendencë të mos shkojnë në shkollë, kanë simptome psikosomatike. Studime kanë argumentuar se këta fëmijë kur të rriten kanë prirje ndaj depresioneve. Në disa vende në të cilat përcillet dhe dokumentohet se numri i vetëvrasjeve të fëmijëve janë pjesë edhe e keqtrajtimit të fëmijëve në shkollë.

Në Sk.3 është paraqitur itinerari i pasojave të mundshme nga zbatimi i dhunës psikike mbi fëmijë.

Fyerja dhe ofendimi janë sulm që ka për qëllim të godet vlerat, karakteristikat të cilat njeriun e bëjnë njeri (p.sh. kur mësimdhënësi i thotë vajzës “lopë” ai atë e bënë të pa denje, sepse e kategorizon në kategorinë e kafshëve që ka kuptimin e mungesës së dijes, aftësisë etj). Vajzat e tillë ndjehen keq para shokëve dhe shoqëve vendosen në situata konfliktuoze. Nuk dinë si të reagojnë. Nëse mësimdhënësi është autoritet i pacenueshëm, atëherë ajo heshtë, por ndjehet e fyer dhe thyer. Nëse fillojnë edhe shokët dhe shokët ta përqeshin dhe të tallen me te, ajo më nuk ndjehet e dinjitetshme, humb besimin në vlerat, forcat, aftësitë e veta fizike, psikike dhe sociale. Tërhiqet në vete. Në situatë konfliktuale reagon duke qarë. Në mësim nuk përqendrohet, humb motivin për punë. Rezultat i kësaj është sukcesi i dobët, pasqyra për veten është negative. Tërhiqet në vetmi. Është e ndrojtur, e pasigurt në situatat e reja, ka frikë nga paraqitjet publike etj. Kjo mund të ndodhë kështu edhe me fëmijët që kanë talent dhe prirje të veçanta të cilit si edhe fëmijët mesatar dhe ata që kanë vështirësi në nxënie. Me një fjalë, mësimdhënësit me veprimet e këtilla, dëmtojnë rëndë zhvillimin e plotë dhe të shëndosh të personalitetit të nxënësit. Studimet në SHBA, në vitet e 70 të shekullit të kaluar, kanë treguar se mësimdhënësit me tendenca neurotike për dy muaj i krijojnë të njëjtat tendenca të fëmijët - nxënësit e tyre. Ky rrugëtim tregon dhe dëshmon se shkelja e të drejtave të fëmijëve dhe ushtrimi i dhunës mbi ta është vërtetë krim, jo vetëm mbi fëmijë por edhe për të ardhmen e shoqërisë.


Në shembullin konkret reagim mund të edhe ndryshe. Nëse nxënësja e fyer ka përkrahje, është sigurt, kjo mund të reagojë me agresivitet ndaj fyerjes dhe ofendimit të mësimdhënësit. Forca e saj dhe vetëbesimi e bënë atë që ndaj mësimdhënësit të sillet me armiqësi. Përsëritja e këtyre sjelljeve krijon modelin e sjelljes agresive tek nxënësja e cila mund të gjenerelazohet dhe tek personat tjerë dhe kështu kjo mund të bëhet ushtruese e dhunës.

3.6.2.4. Krijimi i një rrjeti hipotetik Mbrojtës të mjediseve dhe të adresimit e të parandalimit të dhunës


Me qëllim të përcaktimit të një itinerari të adresimit të dhunës, parandalimit të saj dhe krijimit të një Rrjeti mbrojtës për MJEDISE TË SIGURTA jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkollë është krijuar modeli në vazhdim.

¹⁴ Hyseni, H.(2003) Drejta e fëmijës në sytë e nxënësve kosovarë, Prishtinë, KEC, f. 82-85

Sk. 2. Cikli i pasojave të mundshme për nxënës nga fyerjet dhe ofendimet e mësimdhënësve të tyre




Me qëllim të luftimit të dhunës psikike(edhe asaj fizike dhe formave të tjera të dhunës) në shkollë propozojmë një mekanizëm - **një rrjet mbrojtës** që synon mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e shkeljes së drejtave të fëmijës).Ky mekanizëm shërben për adresimin e dhunës fizike dhe psikike. Itinerari i adresimit të dhunës paraqitet në Sk.3.



Sk.3. Mekanizmat dhe rruga e adresimit dhe të parandalimit të dhunës mbi fëmijë /MEKANIZMI MBROJTËS QË DUHE TË NDËRTUAR/

Ky rrjet strukturor i mekanizmeve me një rrugë të qarkullimit të informacioneve si formë e këmbimit e të adresimit të dhunës mund të shërbej si kthesë civilizues në ndërtimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme në Kosovë , si në Sk.3



Sk.4. Kthesa civilizuese e dhunës në mjedise të sigurta dhe jo të dhunshme dhe humane / miqësore për fëmijë

3.7. Veprimtaritë edukative të mësimitdhënësve në funksion të edukimit për të drejtat e fëmijës

Në vlerësimin e **gjendjes së drejtave të fëmijës kemi dëshiruar të konstatojmë së çfarë mësimitdhënësit bëjnë për mbrojtjen e dhe avancimin e gjendje së drejtave të fëmijës si dhe në krijimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme e humane.** Për këtë qëllim në pyetësor kemi shtruar pyetje që lidhen:

1. Me planifikimin e veprimtarive për edukimin e nxënësve për të drejtat e fëmijë
2. Me realizimin e përgjegjësi dhe të detyrave nga nxënësit
3. Me realizimin e veprimtarive jashtëshkollore që lidhen me të drejtat e fëmijës
4. Me pjesëmarrjen prindërve në veprimtaritë që zhvillohen në shkollë që lidhen me të drejtat e fëmijës
5. Me mënyrat se si mësimitdhënësit i trajtojnë të drejtat e fëmijës
6. Me ndikimin mjedisit në krijimin klimës së besimit dhe të sigurisë
7. Me nevojën për botimin një gazetë të veçantë për të drejtat e fëmijës
8. Me treguesit që shfaqen në mënyrë më të dukshme në veprimtaritë e realizuara në marrëdhëniet ndërmjet mësimitdhënësve dhe të nxënësve

3.7.1. Si i planifikojnë mësimitdhënësit e arsimit të detyruar veprimtaritë që lidhen me edukimin e për të drejtat e fëmijës?


“Të dështosh në planifikim do të thotë të planifikosh dështimi”

Në edukimin për të drejtat e fëmijës planifikimi, parashikimi dhe projeksione kanë rëndësi të madhe, sepse me planifikim parashikohen vizionet, synimet, qëllime, objektivat të cilat në formën piketave na tregojnë jo vetëm ku duhet të arrijmë, por edhe çfarë duhet të bëjmë për arritjen e piketave të tilla (kjo do të thotë duhet t'i planifikojmë përmbajtjet e punës, mjetet dhe instrumente me të cilat duhet të prezantojmë ato përmbajtje, metodat dhe format e punës, mënyra dhe instrumentet për vlerësimin e rezultateve të punës etj). Në vlerësim kemi dashur të konstatojmë a planifikojnë mësimitdhënësit veprimtaritë e caktuar edukative për edukimin dhe arsimimin nxënësve për të drejtat e fëmijës.

Për këtë qëllim kemi parashtruar pyetjen; *“A Planifikoni në mësimitdhënien tuaj veprimtari që lidhen me edukimin për të drejtat e fëmijës?”*

Pas analizë së rezultateve kemi konstatuar se në këtë pyetje nga 93 mësimitdhënës 86 apo 92.5 % kanë deklaruar se planifikojnë veprimtari që lidhen me edukimin e për të drejtat e fëmijës, 5 apo 5.4% kanë deklaruar se nuk planifikon veprimtari të tilla dhe 2 apo 2.2% Përgjigjet e të anketuarve i paraqesim në Gr.19.

Gr.19. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen:” A planifikoni në mësimitdhënien tuaj veprimtari që lidhen me edukimin për të drejtat e fëmijës? “



Nga vlerësimi i shpejtë del se shumica absolute e mësimitdhënësve në procesin e mësimitdhënies planifikojnë veprimtari edukative që lidhen me të drejtat e fëmijës. Kjo gjë është shumë e mirë dhe duhet vazhduar edhe më tutje. Por, realiteti i gjendjes së drejtave të fëmijës në Kosovë i dëshmuar edhe në këtë hulumtim të shpejtë nuk është në lidhje të forta korrelative me këtë përgjigje. **Kjo do të thotë, se duhet bërë hulumtime dhe këshillime që procesi i planifikimit të transformohet në produkte, rezultate më të avancuar në këtë fushë.** Po të kishim një planifikim, realizim dhe monitorim më efikas do të kishim më pak dhunë në shkolla, më shumë siguri, rezultate më të mëdha në mësim, më pa pak drogë, më pak vjedhje, më pak braktisje, efikasitet dhe efektivitet më të lartë të sistemit të arsimit.

3.7.2. Kryerja e përgjegjësive nga nxënësit

Jo rrallë dëgjojmë se fëmijët pse kanë shumë të drejta ata po sillen keq dhe me mospërfillje ndaj detyrave dhe përgjegjësive!!!?

Në këtë rast kemi të bëjmë me një keqkuptim apo keqinformim, sepse e drejta është përgjegjësi, dhe se të drejtat dhe përgjegjësitë janë dy anë të një medaljoni. Për të konstatuar se sa nxënësit janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve shkollore në pyetësor e kemi parashtruar edhe pyetje: *“A i kryejnë nxënësit tuaj detyrat dhe përgjegjësitë e tyre”*

Nga 93 mësimdhënës të anketuar vetëm një mësimdhënës nuk është përgjigjur në këtë pyetje, ndërsa 92 ose 98.9 % janë përcaktuar për përgjigjen “PO”


Edhe ky konstatim është shumë pozitiv, por sikur nuk është përputhet me gjendjen reale, sepse po të ishte me të vërtetë kështu atëherë edhe efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit të arsimit do të ishte shumë më i lartë se sa është. **Ky konstatim bie ndesh edhe me shkallën e braktisjes së mësimin nga nxënësit, por edhe me shkallën e dhunës që ushtrohet ndaj fëmijëve.**

4.7.3. Sa në shkollat e Kosovës realizohen veprimtaritë jashtëshkollore që lidhen me të drejtat e fëmijës ?

Në këtë hulumtim kemi dëshiruar të konstatojmë se sa shkollat janë të hapura ndaj shoqërisë dhe ndaj komunitetit. Për këtë arsye në hulumtimin e shpejtë e kemi parashtruar pyetjen : *“A realizoni veprimtari jashtë shkollore që lidhen me të Drejtat e Fëmijës?”*

Nga 93 mësimdhënës të anketuar 59 apo 63.4 % kanë deklaruar se “PO”, 33 apo 35.5 % kanë deklaruar “JO” dhe 1 apo 1.2 nuk është përgjigjur në pyetjen e parashtruar. Nga ky vlerësim mund të konstatohet se më shumë se një e treta e shkollave janë të mbyllura dhe nuk komunikojnë me komunitetin në fushën e të drejtave të fëmijës. Kjo diskrepancë shihet qartë në Gr.20

Gr.20. Përgjigjet e mësimdhënësve në pyetjen: “A realizoni veprimtaritë jashtë shkollore që lidhen me të Drejtat e Fëmijës?”



Shkolla e mbyllura dhe të izoluar që nuk marrin energji nga jashtë. Janë shkolla jo transparente, jo efikase dhe jo efektive. Në këto shkolla nuk mund të realizohen dhe promovohen të drejtat e fëmijës në pajtim me nevojat reale të fëmijës dhe me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës. Në këtë aspekt për promovimin të drejtave të fëmijës, duhet shtuar autonominë e shkollës në një anë dhe, në anën tjetër, duhet hapur institucionet arsimore ndaj mjediseve të saj të jashtëm.


3.7.4. Pjesëmarrja e prindërve në veprimtaritë që lidhen me të drejtat e fëmijës

Bashkëpunimi intensiv dhe kreativ i mësimeve me prindër është një ndër faktorët e rëndësishëm të realizimit dhe të promovimit të drejtave të fëmijës në institucionet arsimore, **Ky bashkëpunim mund të krijojë mjedise miqësore dhe në familje edhe në shkolla për zhvillimin maksimal të fëmijëve në pajtim me nenet 29 dh 30 të Konventës për të Drejta e Fëmijës.**

Me qëllim që të vlerësojmë pjesëmarrjen e prindërve në veprimtarit edukative që lidhen me promovimin e të drejtave të fëmijës është parashtruar pyetja: “ *A marrin pjesë prindërit në veprimtaritë që Ju zhvillonin në shkollë për të drejtat e fëmijës?*”

Nga 94 mësimeve në këtë pyetje 56 apo 60.2%% janë përgjigjur me “PO” (apo sipas kësaj përgjigje prindërit e nxënësve marrin pjesë në veprimtaritë që zhvillohen për të drejta fëmijës) 33 apo 35.5 % kanë deklaruar me “JO” dhe 4 apo 4.3% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Përgjigjet e mësimeve në këtë pyetje paraqiten në Gr.21

Gr.21. Përgjigjet e mësimeve në pyetjen : “ *A marrin pjesë prindërit në veprimtaritë që Ju zhvillonin në shkollë për të drejtat e fëmijës?*”



Është për brengosje të madhe sepse më shumë se një e treta e mësimeve deklarojnë se prindërit nuk marrin pjesë e në veprimtarit edukative që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës

Për këtë arsye në shkollë duhet forcuar punën këshillave të prindërve dhe bashkëpunimin tyre KSHMDF dhe me KMDF.

3.7.5. Si trajtohen të Drejtat e Fëmijës në procesin e mësimit?

Në hulumtimin e zhvilluar kemi dëshiruar të konstatojmë si trajtohen të Drejtat e Fëmijës në procesin mësimor. Në këtë pyetje mësimeve kanë pasur mundësi të zgjedhin një apo më shumë përgjigje. Përzgjedhjet e përgjigjeve që kanë bërë mësimeve i paraqesim në T- 10

T-12. Mënyrat se si i trajtojnë mësimeve të drejtat e fëmijës në mësim

Nr.	Mënyrat e trajtimit	Numri	%
1.	Përmbajtjet e edukimit për të drejtat e fëmijës i lidhin me temat mësimore të cilat i zhvillojnë në orë (LTM)	64	68.8

2.	Zhvillojnë veprimtari të veçantë (ZhVV)	30	32.3
3.	I realizojnë në varësi të metodave (RVM)	65	69.9%


Siç mund të konstatohet në të shumtën e rasteve mësimit mësimdhënësit veprimtarit që lidhen me të drejtat e fëmijës i trajtojnë në mënyrë integrale me procesin e mësimit qoftë duke i lidhë këto përmbajtje me temën e caktuar mësimore të njësisë mësimore (kështu deklarojnë 64 apo 68.8%), qoftë duke i realizuar këtë përmbajtje në varësi të metodave të cilat mësimit mësimdhënësi i përdorë në zhvillimin procesit të mësimit (kështu deklarohen 65 apo 69.9% të mësimit mësimdhënëseve)

Veprimtari të veçanta realizojnë 30 apo 32.3 % të mësimit mësimdhënëseve. Përgjigjet e mësimit mësimdhënëseve në pyetjen: “Si i trajtoni të Drejtat e Fëmijës në procesin e mësimit?” paraqiten në Gr. 22.

Qasja e integruar e trajtimit të temave që lidhen me të drejtat e fëmijës t me përmbajtjet e mësimit është shumë e preferuar, sepse në këtë mënyrë realizohen për një kohë dy qëllime:

- Mësimi lidhet me jetën
- Në mësim zhvillohen dijet, shkathhtësitë, shprehitë dhe vlerat të cilat njeriun bëjnë njeri, duke i respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti.
-

Gr.22. Përgjigjet e mësimit mësimdhënëseve në pyetjen:” Si i trajtoni të Drejtat e Fëmijës në procesin e mësimit?”



3.7.6. A ndikojnë mjedisi dhe komunikimi në shkollë në krijimin klimës së besimit dhe të sigurisë?

Në mesin e pyetjeve të tjera në vlerësimin e shpejtë ka qenë edhe një pyetje në të cilën mësimit mësimdhënësit është dashur t'i përgjigjen me : “PO “ ose me “JO”. Me këtë pyetje ne kemi dëshiruar të konstatojmë se mjedisi dhe komunikimi në shkollë a ndikojnë në krijimin klimës së besimit dhe të sigurisë në shkolla dhe në realizimin dhe jetësimin të drejtave të njeriut . Natyrisht që përgjigja ka qenë pozitive sepse nga 94 mësimit mësimdhënëse 85 apo 91.4 kanë deklaruar “PO”, ndërsa 2 ose 2.2 % janë përgjigjur me “JO” dhe 6 apo 6.5 %. Nëse nisemi nga kjo përgjigjet e që edhe në studimet e shumta meta-analitike është vërtetuar se mjediset tërheqëse dhe estetikisht të bukura zhvillojnë moralin të nxënësit, nxisin inspirimin dhe përqendrimin e fëmijëve, kultivojnë përgjegjësinë ndaj ambientit, krijojnë ndjenjën dhe dashurinë për të bukurën dhe natyrën , atëherë mund të përfundojmë se mjediset estetikisht jo të bukura , jo të shëndetshme cenojnë

të drejtat e shumta të fëmijës. Për fatin e keq të nxënësve dhe të shoqërisë kosovare një pjesë e madhe e objekteve shkollore nuk janë estetikisht tërheqëse dhe të shëndetshme . Objektet e këtilla drejtpërdrejt ndikojnë në zhvillimin shprehive dhe sjelljeve jo të mira të fëmijëve.

Komunikimi dhe transparenca **zhvillojnë marrëdhënie të mira ndërmjet nxënësve dhe të mësimitdhënësve. Marrëdhëniet e mira krijojnë klimë miqësore, ndërsa klima miqësor mundëson zhvillimin plotë të fëmijës.**


Për këtë arsye në të gjitha shkollat duhet bërë ndryshime rrënjësore në mjedisore si dhe duhet analizuar marrëdhëniet , duke insistuar në transparencë , në demokraci barazi dhe drejtësi sociale.

3.7.7. A kanë nevojë shkollat për një gazetë- revistë të veçantë e cila u dedikohet të drejtave të fëmijës?

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së nxënësve në vendimmarrje, të marrjes së përgjegjësisë për zhvillimin e tyre, në vlerësimin e shpejtë kemi dëshiruar të konstatojmë se çfarë mendojnë mësimitdhënësit lidhur me editimin një gazete apo fletushke për të drejtat e fëmijës në shkollë dhe një gazete kushtuar të drejtave të fëmijës e cila do të botohej në Kosovë . Për këtë qëllim e kemi parashtruar pyetjen :” *A duhet që shkolla e juaj ta ketë një gazetë të veçantë për të Drejtat e Fëmijës?*”

Në këtë pyetje nga 93 mësimitdhënës 82 apo 88.2% janë përgjigjur me “PO”, 8 apo 8.6 % janë përgjigjur me “JO” dhe 3 apo 3.2 % nuk janë përgjigjur fare. Këto përgjigje janë paraqitur në Gr. 23

Gr.23. Përgjigjet e mësimitdhënësve në pyetjen :” *A duhet që shkolla e juaj ta ketë një gazetë të veçantë për të Drejtat e Fëmijës?*”



Gazeta apo revista që do të botoheshin në shkolla kushtuar të drejtave të fëmijës do të kontribuonte shumë në vetëdijësimin mësimitdhënësve, nxënësve, prindërve dhe të opinionit publik për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta , jo të dhunshme dhe humane për formimin qytetarëve të përgjegjshëm dhe për zhvillimin demokracisë në shoqëri , si dhe për demokratizimin e sistemit të edukimit dhe të arsimit.

Jam i prirë të besoj që KSHMDF, KMhDF, në bashkëpunim me komunitetin dhe në parimin komunitarizimit (bashkëpunimit të individit me shoqërinë) . Një gazetë ose

reviste që do të botohej enkas për drejta e fëmijës në Kosovë do të ishte një kapital i fuqishëm investues për zhvillimin Kosovës dhe demokratizimin e saj. Editimin i saj do të mund të ndihmohej nga MASHT, Shoqëria Civile , Këshilli i Prindërve të Kosovës dhe nga Këshilli Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

3.7.8. Cilit janë treguesit që më së shpeshti shfaqen në mënyrë të dukshme në marrëdhëniet nxënës – mësimit që janë rezultat e veprimtarive edukative për të Drejtat e fëmijës

Në vlerësimin shpejtë kemi dëshiruar të konstatojmë cilit janë ata tregues të cilit që më së shpeshti manifestohen në mënyrë të dukshme e që janë rezultat e veprimtarive që lidhen me aktivitetet e zhvilluara në procesin e edukimit të drejtave të fëmijës. Treguesit më të shpeshtë dhe më të dukshëm që janë shprehur dhe që janë deklaruar nga mësimit në paraqiten në T- 11

T-13. Tabela e treguesve që më së shpeshti shprehen në raportet nxënës – mësimit dhe që janë rezultat i aktiviteteve edukative për të rejtat e fëmijës

Nr.	Treguesit më të shpeshtë dhe të dukshëm në raportet nxënës mësimit që janë rezultat i aktiviteteve edukative për të Drejtat e Fëmijës	Numri	%
1.	Ka më pak konflikte nxënës - mësimit - mjedis jo i dhunshëm - MJDh	56	60.2
2.	Realizohen gati të gjitha detyrat- PShP	30	40.9
3.	Nxënësit shprehin mendimet e tyre për çdo o gjë - lira e shprehjes së mendimit - LShMF	75	80.6
4.	Mjedisi më i pastër - mjedis i përshtatshëm për të nxënë MPN	46	49.5
5.	Fëmijët e konsiderojnë shkollën si një familje kë nxënësit , mësuesit dhe prindi punojnë së bashku - mjedis miqësor për fëmijë MMF	66	71.0

Në këtë hulumtim është konstatuar forca dhe rëndësia e edukimit të nxënësve për të drejtat e fëmijës. Kjo forcë është vërtetuar nëpërmjet katër treguesve të fuqishëm që lidhen me jo vetëm me mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane miqësore , por edhe me të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Së pari , siç edhe shihet në tabelë edukimi i nxënësve për të drejtat e fëmijëve **ndikon në zvogëlimin konflikteve** në shkollë dhe në kuadër të kësaj edhe të **konflikteve ndërmjet mësimit dhe të nxënësve**. Nga 93 mësimit të përfshirë në hulumtim **56 apo 60.2% kanë deklaruar se edukimi për të drejtat e fëmijës ka ndikim në zvogëlimin e konflikteve në shkollë**. Kjo tregon qartë se edukimi për të drejtat e fëmijë është mjet i fuqishëm i krijimit të mjedisve jo të dhunshme, sepse duke zbatuar edukimin për të drejtat e njeriut fëmijët edukohen për tolerancë, respektim të drejtave të tjerëve, i zhvillojnë aftësitë për zgjidhje konstruktive dhe jo të dhunshme të konflikteve.

Aspekti tjetër i dobishëm i edukimi të drejtave të njeriut është **shtimi i përgjegjësisë qytetare ndaj detyrave dhe obligimeve** . Siç shihet mund të konstatohet në këtë hulumtim nëpërmjet edukimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës fëmijët ndërgjegjësohen për punët dhe detyrat e tyre e cilat më pas kanë impakt të fuqishëm në ngritjen e cilësisë së sistemit të edukimit, zhvillimin plotë të personalitetit të nxënësit në aspektin fizik , mentale,

emocional dhe sociale. Në vlerësimin e shpejt shihet se **30 apo 40.9 % të mësimitdhënësve** deklarojnë se edukimi për të drejtat e njeriut ka ndikuar në realizimin detyrave nga nxënësit.


Treguesi më i dukshëm i shprehur në raporte – nxënës mësimitdhënës që është rezultati zbatimit të edukimit për të drejtat e fëmijës është **liria e shprehjes së mendimit dhe të fjalës**. Nga 93 mësimitdhënës të përfshirë në hulumtim, **75 apo 80.6 % kanë deklaruar se zhvillimi i aktiviteteve edukative për të drejtat e fëmijës ka ndikim lirinë e shprehjes së mendimit dhe të fjalës**.

Edukimi për të drejtat e fëmijës ka ndikuar po ashtu që mjediset shkollore të jenë më të patra dhe më të përshtatshme për të nxënësit e suksesshëm. Këtë tregues nga 93 mësimitdhënës të përfshirë në hulumtim e kanë theksuar 47 apo 50.5% të mësimitdhënësve.

Treguesi tjetër i fuqishëm i theksuar nga mësimitdhënësit që më së shumti shprehet dhe që është i dukshëm dhe që rezulton nga edukimi për të drejtat e fëmijës është: mjedisi miqësor dhe human i krijuar në shkollë që përshkruhet me fjalët: *” Fëmijët e konsiderojnë shkollën si një familje ku nxënësi, mësuesi dhe prindi punojnë së bashku ”*

Relevanca e shprehur nëpërmjet përqindjes së mësimitdhënësve që kanë apostrofuar treguesit sipërpërmendur paraqitet në Gr. 23

Gr.24. Treguesit më të shpeshtë dhe më të dukshëm në raportet nxënës-mësimitdhënës që janë rezultat i aktiviteteve edukative për të Drejtat e Fëmijës



Legjenda:

MJDh - Mjedise jo të dhunshme - Më pak konflikte

PShP - Përgjegjësi e shtuar në punë – Realizohen pothuajse të gjitha detyrat nga fëmijët

LShMF – Liria e shprehjes së mendimit dhe e fjalës- Nxënësit shprehin mendimet e tyre për çdo gjë

MNP - Mjedisi i përshtatshëm për të nxënësit e suksesshëm – Mjedisi i shkollës është gjithmonë i pastër

MMN – Mjedisi miqësor për nxënës –Fëmijët e konsiderojnë shkollën si një familje ku nxënësi, mësuesi dhe prindi punojnë së bashku

Duke pasur parasysh këta tregues të konstatuar në hulumtim të cilit rezultojnë nga zbatimi i edukimit për të drejtat e fëmijës , del përfundimi se edukimi për të drejtat e fëmijës duhet të fuqizohet akoma më shumë .

3.8. Si udhëheqësit dhe mësuesit shkollave e vlerësojnë sigurinë në shkollë dhe në komunitet?

3.8.1. Siguria në shoqëri dhe në shkollë nga këndi i KDF

Me mjedise shkollore nënkuptomë të gjitha ato hapësira në të cilat fëmijët zhvillojnë aktivitete të ndryshme argëtuese-zbavitëse dhe mësimore të cilat janë në funksion të zhvillimit të personaliteti të tyre të plotë në pajtim me nenet:27, 28, 29 dhe 30 të Konventës për të drejtat e fëmijës.

BOKS.1. Neni 27, Pika 1&3. e Konventës për të Drejtat e fëmijës

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivele jetesës të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror
- 3 Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat tjerë përgjegjës për fëmijën, që vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin

BOKS.2. Neni 28 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijë për arsimim dhe me qëllim që të arrihet kjo, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:
 - (a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm
 - (b) Inkurajojnë zhvillimin formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm ashtu, dhe profesional, bëjnë ato të hapura e të mundshme për [çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;
 - (c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;
 - (d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor profesional;
 - (e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës
2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijë dhe në përputhje me këtë Konventë
3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtarë në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

BOKS.4. Neni 29 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:
 - a. Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhurive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës
 - b. Të rrisë respektin për të drejtat dhe liritë themelore, dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
 - c. Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin tij, gjuhën dhe vlerat kulturore të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i vet veti;
 - d. Të përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe të miqësisë ndërmjet popujve, njerëzve, grupeve etnike kombëtare, religjioze dhe të personave me origjinë autoktone – indigjene
 - e. Të zhvillojë respektin ndaj mjedisit natyror
2. Asnjë pjesë e këtij neni e as t Neni 28 nuk nënkupton lirinë e ndërhyrjes në lirinë e individëve dhe të organeve të themeluara...

BOKS.5. NENI 30 I KDF

Në shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmijë që i përket minoritetit ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën vetë, ose të përdore gjuhën e vetë së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

IV. TIPAT E MJEDISEVE NË SHOQËRI DHE SHKOLLA DHE NDËRLIDHJA E TYRE

Në shoqëri dhe në shkolla ekzistojnë ndërmjet tjerash këto tipa të mjediseve:

- ✚ Mjediset familjare (familja e ngushtë, farefisi i gjerë, dajallarët etj)
- ✚ Relacioni - rruga shtëpi i shkollë dhe shkollë shtëpi
- ✚ Mjedisi shkollor (ambienti i brendshëm; ambienti i ngushtë i jashtëm. Ambienti gjerë i jashtëm- komuniteti)
- ✚ Mjedisi shoqëror (komuniteti: lagjja, bashkësia lokale, shteti, rajoni-Ballkani, kontinenti – Evropa; mjedisi global- planeti)

Ndërmjet mjediseve të këtylla ka ndërveprime dhe ndikime të ndërsjella. P.sh. mjedisi i dhunshëm familjar ka ndikim në mjediset tjera të sipërpërmendura, sikur të gjitha këto mjedise varen dhe ndikojnë në mjedisin e gjerë shoqëror, fshat, qytetet, rajon shtet, i cili po ashtu jo vetëm që varet nga mjediset shoqërore rajonale dhe botërore, por kanë ndikime në to.

Ajo është me rëndësi të kuptohet është se mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane dhe miqësore për fëmijët janë të rëndësishme së veçanta për zhvillimin e plotë të personaliteti të fëmijës. Për këtë arsye nëpërmjet projektit: **Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla**, synojmë të kontribuojmë në ndërtimin mjediseve të tilla në të cilat është e mundur njeriu të zhvillojë të gjitha potencialet e tij fizike, mentale emocionale dhe sociale.

Për të krijuar në pasqyrë më reale për gjendjen e mjediseve shkollore, siç e kemi përmendur edhe në Prologun e këtij raporti kemi bërë edhe një studim metatanalitike të hulumtimeve të zhvilluara në Kosovë për aspekte e ndryshme mjediseve në shoqëri dhe në shkolla dhe për gjendjen e disa fenomeneve dhe të dukurive të cilat janë shkak dhe pasojë e gjendjes së sigurisë e cila si në Kosovë, ashtu edhe në Ballkan , paraqitet si e brishtë dhe jo miqësore për fëmijë , nxënës në veçanti dhe për njeriun në përgjithësi.

Kjo gjendje me siguri duhet të ndërrojë. Përpjekjet e shumta të bëra nga forcat progresive dhe humaniste kanë krijuar një bazë solide ndërkombëtare juridike, por e cila për shkak të interesave të ndryshme, dallimeve të mëdha në zhvillim, shkallës jo të mjaftueshme të vetëdijes që është pasojë efikasitet dhe të efektivitetit jo të volitshëm të sistemeve të edukimit dhe të arsimit nuk po zbatohet. Moszbatimi i infrastrukturës juridike ndërkombëtare shtron nevojën e edukimit ndërkombëtar internacionalist për të cilën gjë angazhohet UNESCO, por e cila për shkak të etatizimit të shteteve dhe dhënies prioritet të elementit të shtetësisë(në kuptimin një aparati restriktiv dhe ndëshkues) para të drejtave të njeriut nuk po arrijnë do të t'i arrijnë synimet e proklamuar.

Që të arrihet një paqe pozitive apo aktive , ashtu siç thotë Johan Galtung, ne duhet të veprojmë në mënyrë lokale dhe të mendojmë në mënyrë globale. Kjo do të thotë se duhet të angazhohem për krijimin e dhe pastrimin e “oborreve “ tona, e më pas të dalim në lagje, komune, zonë, rajon etj.

Ky parim kërkon që duke u nisura nga parimet globale se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe në barabartë dhe se duhet të jetojnë në vëllazëri (Nen 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut- DUDNJ) kërkon që në mjediset tona të krijojmë kushte dhe mjedise të tilla të sigurta, jo të dhunshme dhe humane, në të cilat, secili nxënës pavarësisht prej prejardhjes së tij të zhvillojë personalitetin e plotë të tij, deri aty, ku janë potencialet e tij maksimale fizike, mentale , emocionale dhe sociale.


Raportet dhe kompleksiteti i mjediseve të këtilla në mënyrë të simplifikuar është paraqitur në skicën

Në këtë skicë përmes shigjetave është paraqitur ndërlidhja reciproke, ndërmjet mjediseve të ndryshme, duke filluar nga mjedis familjar deri te ai global planetar-botëror.

Nga shikimi sipërfaqësor i skicës mund të konstatohet se ndikimi i sigurisë në familje ndikon në sigurinë në shkollë.

Në familjet e dhunshme, ku ka grindje, ku përdoret droga, alkooli, fëmijët frustrohen , tërhiqen në vete, ose bëhen agresiv apo e humbin besimin në forcat e veta (nuk thuhet kot se dhuna sjell dhunë). Nga familja këto modele bartën në shkollë dhe në shoqëri dhe anasjelltas.

Me një fjalë pasiguria në familje nxitë pasigurinë në shkollë dh anasjelltas. Andaj komunikimi shkollë familje shoqëri është shumë më rëndësi



Sk. 5. Kompleksiteti i krijimit të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme në Shoqëri dhe shkolla

4.1. Si e vlerësojnë sigurinë shkollore udhëheqësit dhe mësuesit në arsimin e detyruar ?

Me qëllim që të krijojmë mekanizma të qëndrueshëm për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla në hulumtim kemi dëshiruar të konstatojmë cilat janë opinionet e drejtorëve të shkollave për llojet e caktuar të sigurisë në shkolla.

Vlerësimet e drejtorëve të shkollave paraqiten në T-12.

Në hulumtim të shpejtë i kemi përcaktuar 6 lloje të sigurisë:

1. **Siguria fizike**(mospërdorimi i dhunës- fizike, rrahjet, ndëshkimet fizike, fyerjet, sharjet , përçmimet, përjashtimet nga shoqëria etj)
2. **Lëvizja e lirë**(shkollë shtëpi dhe shtëpi shkollë, lëvizja e lirë në komunitet)
3. **Siguria sociale e fëmijëve** (ushqimi,librat , varfëria)
4. **Siguria shëndetësore**(higjiena në shkollë, tualete, në mjedisin e jashtëm shkollor)
5. **Siguria arsimore**(cilësia e mësimdhënies, metodat, mjetet e punës, këshillimet profesionale të shkollës etj)
6. **Barazia ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike që mësojnë në shkollë**(siguria e të gjitha bashkësive etnike , **shkala e bashkëpunimit, etj**)

Opinionet e mësimdhënësve dhe të drejtorëve për llojet e sipërpërmendura të sigurisë i paraqiten në T-12.


Nr	Llojet e sigurisë	Gjithsej	5	4	3	2	1	Nota mesatare
1	Siguria fizike	101	28	41	23	7	2	3.8
2.	Siguria sociale	96	14	35	33	9	5	3.5
3.	Siguria shëndetësore	101	39	28	20	6	8	3.8
4.	Siguria arsimore	97	39	34	18	4	2	4.1
5.	Lëvizja e lirë e nxënësve	96	79	9	5	2	1	4.7
6.	Barazia ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike	68	53	8	4	2	1	4.7

T-12. Vlerësimet e mësimdhënësve dhe të drejtorëve të shkollave për llojet e ndryshme të sigurisë në shoqëri dhe në shkolla

Analiza sipërfaqësore e kësaj tregon se **varfëria, gjendje ekonomike, mungesa mjeteve financiare dhe materiale më së shumti** kanë ndikim në sigurinë e nxënësve dhe të mësimdhënësve në Kosovë. Ky vlerësim përputhet me rezultate e hulumtimeve të tjera , në të cilat **papunësia, varfëria dhe varfërie skajshme** paraqesin problemin më të madh të Kosovës. Sigurisht që kjo **pasiguri** ka ndikim edhe ne llojet tjera të **sigurisë** sepse varfëria ka ndikim në **gjendjen shëndetësore, në zhvillimin fizik**, por edhe në **suksesin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për mësim** sepse mos përgatitja për mësim pos që sjellë **frikë shqetësim, ndjenjën e turp, ankthit dhe të stresit** si të nxënësit ashte edhe tekë fëmijët, ajo ndikon në **braktisjen e mësimi, angazhimi në punë të cilat janë të dëmshme për shëndetin e fëmijës, në lypësi ,bredhje të kotë rrugëve** që mund të çon drejtë **delikuencës dhe të narkomanisë** etj.

Vlerësime më të larta marrin lëvizja e lirë e cila vlerësohet 4.7 dhe barazia ndërmjet bashkësive etnike (nxënësit dhe mësimdhënësit e bashkësisë etnike serbe nuk kanë pranuar që të përfshihen në hulumtim). Ne mendojmë se këto vlerësime janë reale sepse edhe me hulumtimet tjera të zhvilluara marrëdhëniet ndërmjet bashkësive etnike konsiderohen të drejta në kontaktet e përditshme. Po ashtu para të gjitha bashkësitë etnike para ligjit janë të barabartë, edhe pse **pozita bashkësia rome, ashkalive dhe e egjiptianve është jo e mirë dhe për shkak të përfshirje shumë më atë ulët në të gjithë aktivitet shoqërore**. Siguria fizike dhe shëndetësore vlerësohet me notën tresh si e mirë.

Gr. 25. Vlerësimet e mësimdhënësve për disa lloje të sigorisë në shoqëri dhe në shkolla



4.2. Dëshmi dhe fakte nga disa studime meta-analitike të bëra në Kosovë?

Për të bërë një zbardhje sa më të plotë të gjendjes së sigurisë në shoqëri dhe në shkolla e Kosovës kemi organizuar edhe disa studime meta-analitike. Studimet meta-analitike të rezultateve të hulumtimeve të bëra në Kosovë tregojnë se gjendja e mjediseve të tashme në Kosovë është e pasigurtë, me shumë elemente të dhunës. Kjo gjendje këto mjedise i bënë jo humane dhe jo miqësore jo vetëm për fëmijë por edhe për të rritur.

Studimet tregojnë se fëmijët e moshës 6-10 vjeçare kanë pasur përvojë personale të dhunës(29%) se ekziston frika nga suksesi i dobët në shkollë; se fëmijë ndihen të frikësuar në familjet e tyre(13%) etj¹⁵

Siguria e mjediseve shkollore në Kosovë është e brishtë edhe për shkak të rritjes përdorimit të duhanit në mesin e të rinjve, përdorimit të drogës dhe alkoolitit, pedofilisë dhe pornografisë dhe të “cyber krimit”.

Në një studim të zhvilluar nga Qendra për Drejtat e Njeriut të Universiteti të Prishtinës tregohet për rritjen e numrit të rinjve që përdorin drogën, alkoolin, duhanin, dhunën etj.

Disa nga rezultatet e këtij studimi i paraqesim në Gr. 25

Disa nga këto rezultatet të konstatuara në këtë hulumtim paraqiten ng.Gr.25.

Në studimet meta-analitike të rezultateve të hulumtimeve kemi konstatuar shumë shkelje të drejtave të fëmijës nga institucionet të cilat kanë për funksion mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Në këto hulumtime konstatohet se edhe në Policinë së Kosovës shkelen të drejtat e fëmijëve të cilit kanë rënë në konflikt me ligjin. Të miturit e kështu në kundërshtim me ligjet pozitive të Kosovës janë rrahur në zyrat policor. Kështu ka ndodhur me të miturin nga Prishtina i lindur në vitin 1989 i cili ka kryer veprën penale të vjedhjes së lehtë e cila sanksionohet me nenin 252 par.1 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës¹⁶

Po kështu ka ndodhur edhe me të miturin recidivist nga Ferizajit i cili :”... tregon se është rrahur nga policia por për shkak të arsyeve të ndryshme këtë rast nuk e ka lajmëruar. Ai

¹⁵ UNICEF(2005): Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkolla e Kosovës, f: 41-55

¹⁶ Murati, V. Berisha, Qerkin(2008):Masat alternative në sistemin e drejtësisë për të mitur të Kosovës:puna në dobi të përgjithshme si dënim dhe masë e diversitetit, f.48

thotë se është rrahur në një dhomë nga tre policë deri sa e ka nënshkruar atë që policët e kanë thënë të nënshkruaj duke dashur të mos rrihet më”¹⁷. [...]


Ne, po ashtu, në studime meta-analitike, kemi konstatuar se drejtat e fëmijës shkelen edhe për shkak të pa përgjegjësisë së institucioneve të caktuara në kryerjen e obligimeve të tyre ligjore , në një anë, dhe për shkak mosbashkëpunimit dhe të koordinimit të punëve ndërmjet institucioneve të ndërtuar për krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla në anën tjetër.

Pjesa me e madhe e të miturve pas përfundimit masave për veprën e bërë nuk vazhdojnë shkollimin.

Drejtësia restorative në Kosovë është në fillimet e para, andaj rezultatet e para janë inkurajues, por ato duhet të forcohen duke siguruar në numër më të madh të gjykatësve dhe të prokurorëve për fëmijë.

Kështu p.sh. gjatë marrjes së miturit në pyetje në polici duhet të jetë prezent punëtori speciale e që në shumë raste kjo nuk ndodhë. Mos-prezenca e punëtorit sociale me rastin e marrjes së në pyetje të miturit në polici paraqet ndërmjet tjerash shkelje të drejtave të fëmijës

Gr.26. Paraqitja grafike e disa sjelljeve asociale të fëmijëve të mitur



Legjenda:

A.Për.D- A përdoret duhani në mesin e nxënësve të shkollës suaj ?

A. Për.D- A përdoret droga nga nxënësit e shkollës tuaj?

A.Për.Al- A përdoret alkooli nga nxënësit e shkollës tuaj?

A KA dh. – A dhunë/rrahje në mes të nxënësve të shkollës tuaj?

Këto rezultate janë shumë interesante. Kështu, p.sh. kur është në pyetje **pirja e duhanit** në studim shihet se ekzistojnë diferenca ndërmjet qendrave të mëdha urbane dhe të qendrave të vogla, por në të gjitha rastet mbi 50% të anketuarve kanë deklaruar se **duhani konsumohet nga nxënësit** e shkollave të anketuara. Por, gjendja me alarmante është në Skenderaj (95% kanë deklaruar se pihet duhani në shkollat e tyre) , në Gjakove(95); në Pejë (92%), Lypjan (90%) etj.

Kur është në pyetje **droga** si vende më alarmante, ku numri më i madh i të anketuarve kanë deklaruar se **droga konsumohet nga nxënësit e shkollës tyre janë: Prishtina(42%), më**

¹⁷ Po at, f.49.

pas vjen, **Prizreni** me **23 %** dhe **Lypjani** me **18%**. Ajo që është shqetësuese, është se **droga ka arritur gati në të gjitha shkollat dhe në të gjitha qytetet e Kosovës.**

Sipas këtij hulumtimi del se **dhuna e shokëve mbi shokë është përhapur shumë.** Edhe këtu **prin Prishtina** (83% të anketuarve kanë deklaruar ka dhunë - rrahje në mes të nxënësve në shkolla e tyre), më pas vjen Lypjani (me 80%) ;Peja dhe Deçani (79%); Gjakova (75%).

Në këtë hulumtim në Komunën e Prishtinës 8% të nxënësve deklarojnë se e përdorin drogën, duhanin dh alkoolin. Nëse kjo është e vërtetë atëherë del se diku rreth 2000 të rinjë - fëmijë që ende nuk e kanë mbushur moshën 18 vjeçare janë përdorues të drogës në Prishtinë. Në këtë rast kemi menjëherë përgjigjet e nxënësve të Pejës , Deçanit, Gjakovës, të cilët me një përqindje mbi 50 kanë deklaruar se përdorin drogën, duhanin dhe alkoolin((Gjakovë-75%; Pejë- 50%; Deçan 78%; Prizren 82&, etj).

Në hulumtimin e Qendrës për të Drejtat e Njeriut janë parashtruar dhe pyetje që lidhen me masat edukative:

A mësoni për dukuritë negative në orët e mësimi(vetëm 39.5% të anketuarve deklarojnë se kanë mësuar)

A janë raportet e mira nxënës - profesor në shkollën tuaj(66.3% kanë deklaruar “po”)

A i kushtohet rëndësi orës së kujdestarisë në orën tuaj (53.8% deklarojnë “PO”)

A i diskutoni problemet tuaja me kujdestarin, prindin psikologun etj.?(73..0% janë deklaruar “PO”)

A mendoni se duhet të rritet numri i orëve edukuese për dukuritë negative(vetë, 1.7% deklarojnë “PO”)?

A ka njohuri të mjaftueshme për dukuritë negative në tekste që ju i përdorni(43.4% e deklarojnë “PO”)

Nga ky hulumtim shihet qarë se në funksion të krijimit të mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane për fëmijë duhet punuar më shumë në mbrojtjen sociale të fëmijëve , duke hapur kuzhina shkollore, duke siguruar tekste falas për nxënës dhe duke ndihmuar familje që nuk kanë asnjë të punësuar që të sigurojnë kushte më të mira sociale.

Pamja e objekteve shkollore nuk është e mirë dhe ato nuk i plotësojnë kushtet higjienike as estetike për një zhvillim të plot të personaliteti të fëmijëve në pajtim me nenet 29 dhe 30 të Konventës ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

V. HIPOTEZAT

Studimet meta-analitike dhe hulumtimi i shpejtë i gjendjes së drejtave të fëmijës në Kosovë, na kanë krijuar mundësinë që në të vërtetë hipotezën gjenerale se : **“ Në Kosovë, mjediset nuk janë të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në masë që ato të jenë hapësira të përshtatshme për zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës dhe të vendosjes së njeriut – fëmijës në qendër”**

Me këtë hulumtim i kemi vërtetuar edhe nënhipotezat:

a. Frika dhe pasiguria fëmijëve në Kosovë është e përhapur në masën e cila kalon 50% e popullsisë së fëmijëve të Kosovës

b. Dhuna mbi fëmijë në shoqëri dhe në shkolla është akoma e përhapur në masën që kalon 40% e popullacionit të fëmijëve në Kosovës

c. Në Kosovë nuk ekziston një rrjet i krijuar i qëndrueshëm mbrojtës i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane për fëmijë në shoqëri dhe në shkolla

d. Në Kosovë nuk e ekziston një itinerar i njohur dhe i pranueshëm, funksional dhe adaptibil i adresimit të dhunës që ushtrohet mbi fëmijë dh të rinj dhe një rrjet mbrojt funksional për Mjediset e sigurta jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla

3. KONSTATIMET PËRFUNDIMTARE

1. Nga viti 1999, me përfundimin e Luftës në Kosovë, në mënyrë të vazhdueshme shënohet një rritje , avancim dhe përmirësim i gjendjes së drejtave dhe të lirive të njeriut në përgjithësi , dhe të pozitës së gruas dhe të drejtave të fëmijës në veçanti. Ky konstatim bazohet në rezultatet e hulumtimeve të zhvilluar në Kosovë nga shumë organe dhe organizatë qeveritare dhe joqeveritare. Përmirësimet dhe avancimet në rend të parë janë meritë e bashkësisë së ndërkombëtare e cila , nëpërmjet donacioneve të shumta, ndihmave të ndryshme në veshmbathje, në ushqim , në ndërtimin shtëpive të djegur, të organizmit të trajnimeve të shumta me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve në fushën mësimdhënies; mbrojtjes dhe të promovimit të drejtave dhe të lirive të njeriut, edukimit për të drejtat e njeriut, vetëdijesimit për mbrojtjen e gruas nga të gjitha format e diskriminimit, shfrytëzimit , të dhunës , në fushën e përkrahjes në ndërtimin e institucioneve vendore në parimet e qytetarisë dhe të demokracisë , të shtetit ligjor dhe studimit të ligjit ka krijuar një fond tjetër që dallon nga koha e para luftës.
2. Megjithatë, me gjithë përmirësimet e bëra në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi të avancimit të pozitës së gruas dhe të fëmijëve në veçanti, gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe të lirive themelore në përgjithësi dhe të gruas dhe të fëmijëve në veçanti është shumë, larg standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare .
3. Gjendja ekzistuese e drejtave dhe të lirive të njeriut fëmijës, dhe e pozitës së gruas paraqet një pengesë të madhe për demokratizimin e shoqërisë kosovare, realizimin parimit të deklaruar për barazi dhe drejtësi qytetare dhe sociale.
4. Një nga faktorët që kanë ndikuar që kjo gjendje të jetë kështu çfarë është , janë mjediset e pasigurta (korniza e jo e mira dhe e pa-mjaftueshme juridike , moszbatimi i ligjeve apo vetëdija e ulët për zbatimin e ligjeve, ekonomia formale, krimi i organizuar, shkalla e lartë e korrupsionit shkalla e lartë e varfërisë dhe e varfërisë ekstreme që kategorizohen në dhunë strukturore si për qytetarë dhe ashtu edhe për fëmijë, mjediset e bënë të dhunshme jo humane dhe jo miqësore për fëmijë) me elemente të llojeve dhe tipareve të ndryshme të dhunës, të cilat tipare mjediset e këtilla i bënë të dhunshme dhe jo miqësore për fëmijë.
5. Në hulumtimin e shpejtë kemi konstatuar se si rezultat e vetëdijesimit të publikut, zbatimit të projektit të shkollave miqësore për fëmijë funksionimit të KSHMDF, të punës së KMDF organizimit të trajnimeve të drejtat e fëmijës, dhuna e drejtpërdrejtë

dhuna fizike e mësimitdhënësve mbi nxënës është zvogëluar,(kështu p.sh. dhuna fizike krahasuara me vitin 2003 ka rënë për 9 % ndërsa krahasuar me vitin 2005, është zvogëluar për 5 %, ndërsa dhuna psikike është zvogëluar për më shumë se katër herë krahasuar me vitin vitin 2003)

6. Mirëpo, përballë zvogëlimit të dhunës fizike dhe psikike të mësimitdhënësve mbi nxënës, kemi një rritje rapide të keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët moshatarë. Keqtrajtimi i fëmijëve nga fëmijët moshatar në vitin 2003, ka qenë dukuri e rastit me një përqindje më të vogël se një përqind , ndërsa tani delikuenca e të miturve është 7.4 %. Është më e madh se sa dhuna fizike e mësimitdhënësve mbi nxënës. Nëse nuk hartohet një projekt për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët treguesit do të rrite në mënyrë rapide , kështu që mjediset në shoqëri do të jenë edhe më të dhunshme dhe pengesë serioze për demokratizimin e shoqërisë kosovare.
7. Në këtë hulumtim kemi konstatuar se edhe dhuna në familje ndaj fëmijëve është zvogëluar. Në një hulumtim të organizuar në vitin 2005 nga KEC, kemi konstatuar se 15 % të fëmijëve të Kosovë kanë qenë objekt dhune, kryesisht nga nëna(fenomen që për ne ka qenë diçka e papritur). Në vitin 2008, sipas këtij hulumtimi të zhvilluar, dhuna mbi fëmijë ka ra nga 15 % në 8%. Si në hulumtimin e parë ashtu, edhe në hulumtimin e shpejtë tregohet se personi që më së shumti ushtron dhunë në familje është nëna.
8. Në hulumtim kemi konstatuar se përdorimi i drogës është në rritje. Rritja e përdorimit të drogës, mjediset në shoqëri dhe shkolla i bënë të pasigurta të dhunshme dhe jo humane, kështu që edhe në këtë aspekte duhet krijuar mekanizma mbrojtës për parandalimin e këtij fenomeni
9. Studimet teorike dhe meta-analitike të faktorëve që kanë ndikim ka treguar se **cyber krimi**(pornografia e, pedofilia, trafikimi i qenieve njerëzore) kanë ndikim negativ në krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla.

Për këtë arsye në kurrikula, tekste mësimore në veprimtari të mësimore ky fenomen duhet të adresohet më qartë dhe më mirë.
10. Drejtësia restorative Në Kosovë është në fillimet e saj. Numri i gjykatësve dhe të prokurorëve për të mitur Kosovë është i vogël, andaj edhe shkelen të drejtat fëmijë edhe atje ku kjo nuk guxon të.
11. Moszgjidhja e ombudspersonit dhe mos caktimi i një ombudspersoni të veçantë për të drejtat e fëmije ka ndikim negative në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në Kosovë
12. Bashkëpunim ndërmjet organeve dhe organizative të ndryshme të shoqërisë civile dhe të institucioneve formale nuk është në nivelin e duhur. Mosbashkëpunimi i programuar dhe i koordinuar vështirëson punën në krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humanë/ miqësore në shoqëri dhe në shkolla

13. Mungon një itinerar i qëndrueshëm dhe funksionale për adresimin e dhunës në Kosovë, si dhe mungojnë mekanizmat e lidhur në një rrjet funksional për krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla
14. Mungon paketa e treguesve sasior dhe cilësor të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla

4. REKOMANDIMET

1. Të intensifikohet akoma më shumë vetëdijesimi i qytetarëve, opinionit publik, i zyrtarëve të institucioneve formale, të shoqërisë civile, të komunitetit të prindërve, të komunitetit të arsimor për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla për rritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit arsimor, demokratizimin e shoqërisë dhe krijimit të shtetit ligjor që siguron barazi, drejtësi dhe siguri sociale për të gjithë qytetarët në të gjithë territorin e Kosovës. Për këtë qëllim duhet hartuar planin nacional të veprimit në të cilën do të parashihet një sistem i qëndrueshëm i zhvillimit të fushatave, organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe të debateve, organizimit të Panairit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës me 10 dhe 20 nëntor, me synim që ky panair të jetë tradicional dhe të ketë karakter rajonal. Të shtojë bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve që kanë përgjegjësi krijimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme
2. Të krijohet një itinerar i qëndrueshëm dhe funksional i adresimit të gjitha shkeljeve të drejtave të njeriut dhe të fëmijës
3. Të krijohet një rrjet i fuqishëm që do të monitorojnë, vlerësojë gjendjen e sigurisë në shoqëri dhe në shkolla
4. Të krijohet një paketë e treguesve cilësor dhe sasiorë për gjendjen e sigurisë në shoqëri dhe në shkolla
5. Të hartohet një plan nacional veprimi me të cilën do të garantohet siguria në shoqëri dhe në shkolla si dhe do të parandalohet dhuna, braktisja e sistemit të arsimit të krijohen mjedise humane dhe miqësore me njerin /fëmijën në qendër, ku të gjithë do të plotësojnë nevojat dhe interesimet e tyre.
Me qëllim që të ndihmohen fëmijët vulnerabel, fëmijët e varfër, fëmijët me nevoja të veçanta në institucione shkollore të hapen kuzhinat shkolle, të rritet autonomia e shkollave; objekte shkollore të rregullohen duke u përgjigjur standardeve shëndetësore, sociale dhe arsimore
6. Të bëhet një rishikim i përgjithshëm i sistemi të arsimit (legjislativ, strukturës, udhëheqjes, menaxhimit dhe administrimit, kurrikulave, sistemit të përgatitjes së kuadrin mësimor, teksteve mësimore) në mënyrë që sistemi i arsimit t'u përshtatet gjashtë shkathësive të shekullit XXI dhe Objektiveve Zhvillimore të Mileniumit të Tretë

7. Në reformën kurikulare të adresohen me qartë roli i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane, si dhe rëndësia e parandalimit të dhunës, pirjes së duhanit, përdorimit të drogës , të konsumimit të alkoolit.
8. Në reformën aurikulare, të përgatitjes dhe të botimit të teksteve qartë dhe në mënyrë shumë argumentuese në përputhje me moshën e nxënësve duhet të adresohen çështjet që kanë të bëjnë me AIDSI-n, krimin në shoqëri, korrupsioni, pasojat e mosrespektimit të ligjit për shoqërinë dhe individin, për CYBER CRIMIN (pedofilinë, pornografia prostitucionin , trafikimin e qenieve njerëzore etj)
9. Pozita e gruas në shoqërinë Kosovare me gjithë përparimet e bëra është shumë larg standardeve ndërkombëtare dhe të nevojave reale. Në kurrikula dhe në tekste shkollore duhet një ndryshim radikale në krijimin e një mendësie të re për rolin e gruas në zhvillimin dhe prosperitetin e shoqërisë)
10. Përfshirja e fëmijëve në edukimin e hershëm është jashtëzakonisht e ulët. Nuk mund të krijohen mjedise të qëndrueshme të sigurta dhe humane me një shkallë kaq të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm parashkollor
11. Me Kushtetutën e Kosovës, Kosova është një vend multikulturor dhe multietnik, andaj duhet forcuar dhe përkrahur pedagogjin e edukimit multikulturor duke krijuar shkolla multikuturore
12. Duhet përkrahur dhe përhapur idetë dhe konceptet e “drejtësisë restorative” me qëllim të risocializimit të fëmijëve që kanë ra në konflikt me ligjin. Duhet shtuar numrin gjykatësve dhe të prokurorëve për të mitur, duhet nxituar dhe stiumulaar *Shërbimin Sprovues të Kosovës*, duke nxitur bashkëpunimin e Qendrave Sociale me Policinë e Kosovës dhe me Institucionet e Arsimit si dhe duhet zgjedhur urgjentisht OMBUDS PERSONIN dhe OMUDS PERSONIN E VEÇANTË për FËMIJË.
13. MASHT duhet të hartojë një plan për vazhdimin shkollimit të fëmijëve që kanë ra në kundërshtim dhe që e kanë ndërprerë arsimin e detyruar
14. Roli mjeteve të informacionit për krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane është esencial. Për këtë qëllim redaksitë e mjeteve të informacionit duhet udhëzuar gazetarët për punë hulumtuese si dhe duhet zhvilluar politika redaktuese të tilla që çojnë drejt rritjes së vetëdijes për rolin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane për shoqëri dhe shkolla.

Litartura:

- Alferdsson, G.& Eide, Asbjörn(?): Deklarat Universale mbi të drejtat e njeriut. Standard i përbashkët që duhet arritur, Prishtinë, Kosovë
- Banks, A.J.(1992) Multithnic Education: Theori and Practice(Bot.IV) Bostaon., Mass.: Allyn and Bacon
- CARE (?) Interanational Conference Report. Promotion of Human Rights Education and – ethnic Dialogue in Kosovo “1+1 =3
- Delors, J(1998) Učenje blago u nama, Zagreb, Educa
- Deklaratë e Hamburgut(1997) Plan – programi për të ardhmen. Dokumenta htmeloreë ndërkombëtarë për arsim dhe të mësuar
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- European Initiative for Democracy and Human Rights (EIDHR)
- Garça, M.(2001): Ndikimi i luftës tek fëmijët. C.Hrust \$ CO, Londër
- Metahasani, E.& Mushkolaj Gj.(2002) Fjalorth terminologjik i të drejtave të njeriut
- Gardner, H.(2003): Mendja e pashkolluar, ISP, Tiranë
- Gardner, H.(2003): dimensionet e mendjes, ISP, Tiranë
- HCN(2003) Kuptimi i i të Drejtave të Njeriut
- Hyseni, H (2004): Të drejtat e nxënësve në sytë e nxënësve kosovarë, KEC, 2004
- Hyseni, H. dhe të tjerë (2006): Të drejtat e njeriut. Manual për të drejte e njeriut dhe të fëmijës
- Hyseni , H.dhe të tjerë(2007): Barazia gjinore në librat e leximit në arsimine detyruar nëntëvjeçar në Kosovë, KEC, Prishtinë
- PSIG, USAID CRSKLC(2007): Plani i veprimit të Kosovës për Luftimin e Trafikimit me Qenia Njerëzore. Aktiviti sipas Matriksit i Raportit Progresiv prej 30 Qershorit 2007, Kosovë
- IPC(2003) Rapid Assesment for Trafficking in Children for Labour and Sexsual Exploation in Albania (2003)
- Minstry of Health, WHO, UNFPA & UNICEF(2006) Perinetal Situation in Kosovo for YEARS , 220-2005
- Molten, M (2002): Të fillosh i ri. Prishtinë
- Save the Children (2002z2003) Si të bëhen realitet të drejte të gjithë fëmijëve në Kosovë
- OSCE Mission in Kosovo(2004) Të drejta e njeriut
- QKDNJ (2002) Anual Raport
- KSGJ(2007) auditivi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor
- UNICEF(2005) Hulumtimi mbi Dhunën Ndaj Fëmijëve në Shkollat e Kosovës
- UNICEF (2005) Qualiti Education for All in Kosovo
- UNICEF (2003) Gender Review in Education
- UNICEF, MEST CRS PTAK (2005) All in School.. Student Retention and Dropout Respoense . Manual Resurse Kit
- UNICEF (2004) Trafiking dece na Kosovu
- UNICEF(2004) Child Labour in Kosovop. A Study on Working Children
- UNICEF(2004) Analiza e gjdnejs së arsimit në Kosovë

UNICEF (2004) Youth in Kosovo
UNIFEM(2002) Propozimi i Planit Veprues për Arritjen e Barazisë Gjinore

DRAFT